# GAZETA SHQIPTARE

KORÇA BEER
edhe sot më e mira ...

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7477 E premte 23 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

KORÇA BEER
edhe sot më e mira ...

Opinioni i Ditës

Nga FITIM ÇAUSHI

## Fytyra e vërtetë e "demokracisë" kapitaliste



Me kundërshtitë e deputetëve të Kosovës, u duk se Marrëveshja e Vjenës, 26 gusht 2015, midis Malit të Zi dhe Qeverisë së Kosovës nuk do të prodhonte efekte ... Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Çfarë tha realisht FMN?

Ndryshe nga nëntori i vitit 1996, pak muaj përpara shpërthimit të krizës së firmave piramidale, misioni dyjavor i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) foli ... Vijon në faqen 21



Intervista/ Pse e kundërshtoj variantin e propozuar

# Alfred Bualoti: Teatri s'bëhet me forcë, të zgjidhet projekti më i mirë

"Rama i dhunshëm, s'mund të thonë, 'është ky projekt dhe nuk ka më'"

Nga FATMIRA NIKOLLI

Prej ditës kur kryeministri Edi Rama ka prezantuar projektin për Teatrin Kombëtar, zërat kundër modelit kanë qenë disa. Jo doemos me modelin, artistët kanë kundërshtuar modelin e Partneritetit Publik Privat, për ... Në faqen 15

### KANABISI KAP VLEREN 5 MILIONE EURO, ARRESTOHEN EDHE 10 TE TJERE

# KAPET 1.1 TONE DROGE NE TURQI, PRANGOSET 'BARONI' SHQIPTAR

Kush është Met Kanani apo "Met shqiptari" i cilësuar si kapo i trafikimit të drogës. Mediat turke: Ka lidhje me politikanë shqiptarë



(Në foto) Met Kanani. Droga e sekuestruar

Në faqen 11

INTERVISTA PER "GSH"

### Rudy Giuliani: Muxhahedinët, imazhi i Shqipërisë u përmirësua në SHBA

Në faqen 5

RAPORTI

### Dhoma Amerikane: Në Shqipëri rriten taksat, dhe ra konkurrenca. Lu: Jam i zhgënjyer

Në faqen 8

NGA RRUGET TE HEC-ET

### Zbardhen koncesionet, pronat publike në duar të privatit, vlera deri 504 miliardë lekë

Në faqet 6-7

DESHMIA E LABIT

### Procesi ndaj Zotos, Ekspertët: 728 imazhe nga kamerat e sigurisë për ish-drejtorin

Në faqen 10

FLET BESKIDA ALIAJ




### Hapet faza e parë për studime në Itali, ja si të aplikoni dhe degët ku mund të kandidoni

Në faqet 12-13

"Nuk është hera e parë që lojtari tregon agresivitet, të përjashtohet nga ekipi"

# Sulmohet trajneri i U-17, arrestohet babai i futbollistit

*Nuk i futa në lojë djalin që është kapiten skuadre, më goditi me grushte*

Nga INA ALLKANJARI

Patëm një ndeshje miqësore dhe kapitenin e skuadrës vendosa ta lë pushim pjesën e parë, për ta aktivizuar pjesën e dytë. U mërzit dhe u largua në formë proteste nga ndeshja dhe lajmëroi prindin e



tij. Në kohën që po fusja skuadrën në fushë, erdhi babi i futbollistit dhe filloi të më ofendonte dhe më goditi 4 herë. Më pas tentoi të më godasë me thikë, por u largova". Kështu është shprehur në një prononcim ekskluziv për ... Në faqen 9

# 22 MARSI '92
## OPOZITA

Politikanë dhe diplomatë urojnë për festën, përcjellin mesazhet për paqe

# Sulltan Nevruzi, Meta: Reflektim për vlerat e bashkëjetesës

## *Basha: Dita e ripërtëritjes dhe shpresës*



Valentina Madani

Besimtarët bektashinj në të gjithë botën kremtuan dje si çdo 22 mars ditën e Sulltan Nevruzit, lindjen e Imam Aliut. Kjo festë simbolizon lindjen e shpresës dhe rigjallërimin e natyrës, që përkon edhe me nisjen e pranverës. Mes besimtarëve dhe politikanëve në fjalimin e rastit, Kryegjyshi botëror Haxhi Dede Edmond Ibrahimaj kërkoi më shumë kujdes ndaj personave në nevojë. "Të falemi për njerëzit e mjeruar dhe të vobektët e mbetur në mes të rrugëve pa plang e pa shtëpi, për jetimët dhe nënat e tyre. Zoti i bekoftë!", deklaroi z.Ibrahimaj. Selinë e Kryegjyshatës botërore e vizitoi Presidenti i Republikës, Ilir Meta; krerët e politikës, diplomatë vendës dhe të huaj. Apeli i presidentit ishte për bashkim, që sipas tij sjell një të ardhme më të ndritur. "Kjo ditë e bukur dhe ky manifestim i kapërcen kufijtë e kësaj kryeqendre botërore, edhe kufijtë tanë kombëtarë, duke dhuruar mesazhe të qarta mbi rëndësinë e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit mes besimeve fetare, mes etnive, mes kombeve dhe mes vendeve, për të ndërtuar së bashku një botë të paqtë. Për të dhuruar më shumë dashuri mes njerëzve, më shumë mirëkuptim në gjirin e familjes dhe më shumë optimizëm në zemër të shoqërive tona moderne", theksoi z.Meta. Sipas tij: "Dija, urtësia dhe drejtësia janë tipare të patjetërsueshme, të cilat kanë karakterizuar dhe çuar përpara bashkësinë bektashiane ndër shekuj të ndërthurura harmonikisht me ndjenjën e palëkundur të atdhedashurisë së pashtershme. Kjo ditë e bukur dhe ky manifestim i kapërcen kufijtë e kësaj qendre botërore, edhe kufijtë tanë kombëtarë duke dhuruar mesazhe të qarta mbi rëndësinë e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit mes besimeve fetare, mes etnive, mes kombeve dhe vendeve për të ndërtuar së bashku një botë të paqtë dhe për të dhuruar më shumë dashuri mes njerëzve, më shumë mirëkuptim në gjirin e familjes dhe më shumë optimizëm në zemër të shoqërive tona moderne". Kryeministri Edi Rama zgjodhi të urojë besimtarët bektashinj nëpërmjet "Facebook"-ut. Edhe Kreu i PD-së, Lulzim Basha, nga Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve uroi besimtarët për festën e Sulltan Nevruzit. "Është dita e ringjalljes, është dita që shënon fundin e dimrit, një dimër i egër dhe nisjen e pranverës. Është dita e fitores së dritës mbi errësirën", theksoi z.Basha.



**ERION VELIAJ**

Kreu i bashkisë dhe kryegjyshi Ibrahimaj përfituan nga rasti që në mënyrë simbolike të mbillnin një pemë në selinë e Kryegjyshatës, duke vijuar historinë e nisur një vit më parë me mbjelljen e 70 selvive. "Në shenjë të kësaj dite të shenjtë, ne do të mbjellim një pemë së bashku", tha z.Veliaj.

**URIMI**

"Kjo ditë e bukur dhe ky manifestim i kapërcen kufijtë e kësaj kryeqendre botërore, edhe kufijtë tanë kombëtarë, duke dhuruar mesazhe të qarta mbi rëndësinë e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit mes besimeve fetare, mes etnive, mes kombeve dhe mes vendeve, për të ndërtuar së bashku një botë të paqtë", theksoi z.Meta.

### Dita e Sulltan Nevruzit

## Balla: Të ndërgjegjshëm për të reflektuar të gjithë ne

Kreu i deputetëve socialistë, Taulant Balla, uroi ditën e Sulltan Novruzit si reflektim për të gjithë, përfshirë dhe politikën. "Për urimin e parë në Ditën e Sulltan Novruzit ishim në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane në Tiranë dhe më pas në Teqen e Baba Xhemalit në Elbasan së bashku me kryetarin e bashkisë, Qazim Sejdini, deputeten Evis Kushi, kryetarin e qarkut etj. U uroj të gjithë besimtarëve bektashinj në të gjithë Shqipërinë dhe në të gjithë botën festën më të rëndësishme të këtij besimi, sikurse është dita e re, dita më e rëndësishme për të gjithë besimtarët bektashinj. Le të jetë kjo një ditë jo vetëm e ringjalljes sikurse ka emrin, por le të jetë edhe një ditë e rëndësishme reflektimi për të gjithë ne", tha z.Balla. Ai përmendi se: "Për fat të mirë është një ditë e enjte që Kuvendi i Shqipërisë është pushim dhe kjo të na bëjë edhe më të ndërgjegjshëm për të reflektuar në gjithçka që duhet të bëjmë më mirë në punën tonë të përditshme".



**RRJEDHJET**

### LSI, katër këshilltarë bashkohen me PS

Katër nga dhjetë këshilltarët e LSI në Shkodër, me anë të një letre bën publik vendimin e tyre për t'u larguar nga kjo forcë dhe për t'u bashkuar me PS-së. Ata shprehen se vendimi i tyre ka ardhur pasi: "LSI dhe PD lanë pas krahëve ëndrrën e shkodranëve dhe të gjithë shqiptarëve, duke u investuar në një kthim të fuqishëm kursi nga e shkuara dhe jo nga e ardhmja". Elton Radovani, Roza Dedvukaj, Mirjam Bleta, Sokol Jubica janë katër këshilltarët që u larguan nga LSI në Shkodër, duke e lënë këtë forcë me 6 këshilltarë.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

### "Largimi i këshilltarëve, të lirë të veprojnë"

## Sulltan Nevruzi, Kryemadhi: Drita e Zotit ndriçoftë edhe politikën

Për festën e Sulltan Nevruzit, një urim për komuni tetin bektashi dhe të gjithë shqiptarët bëri edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Ajo u shpreh se uron që drita e Zotit ta bëjë të reflektojë edhe klasën politike shqiptare. "Drita e Zotit u ndriçoftë rrugën të gjithë shqiptarëve dhe të reflektojë klasën politike për t'i dhënë dritë, begati, paqe dhe më shumë forcë shqiptarëve", tha Kryemadhi. E pyetur mbi largimet e këshilltarëve të LSI-së nga këshillat bashkiakë, ajo u shpreh se janë të lirë të shkojnë ku dëshirojnë. "Sot është ditë paqeje, nuk është ditë as për të cilësuar apo për t'u marrë me lajme të vjetra. Dua t'u them edhe diçka tjetër, anëtarët e LSI janë të lirë për të qenë kudo që janë, po di të them që realitetin ku ne jetojmë nuk e ndryshojnë as këshilltarët dhe as deputetët. E rëndësishme është që të ndryshojmë e t'u japim shqiptarëve më shumë punë, më shumë mirëqenie dhe më shumë begati", tha Kryemadhi.

**LARGIMET**

"Dua t'u them edhe diçka tjetër, anëtarët e LSI janë të lirë për të qenë kudo që janë, po di të them që realitetin ku ne jetojmë nuk e ndryshojnë as këshilltarët dhe as deputetët."

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Përvjetori, Berisha: Të ngrihemi dhe të përmbysim narkoshtetin e Edvin Ramës

# 22 marsi, Basha: Thirrje për një zgjim të dytë të shqiptarëve

## *"Të mposhtim diktaturën e krimit"*

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, u kujtoi dje shqiptarëve se 22 marsi i vitit 1992 ishte dita e triumfit të madh, ndaj u bëri thirrje për një zgjim të dytë. Sipas Bashës, 22 marsi i 2018-ës duhet të jetë dita e zgjimit të madh për të mposhtur diktaturën e krimit në Shqipëri. Kreu i PD-së përmendi se 22 marsi mbart një rëndësi të veçantë, historike në jetën e shqiptarëve. "U uroj nga zemra, të gjithë besimtarëve të Zotit, qoftë kjo një ditë e ripërtëritjes së shpresave dhe besimit në Zot, e optimizmit dhe të mirës në zemrat dhe familjet e çdokujt! Është po kështu, 22 marsi historik, dita kur 26 vite më parë, më 22 mars 1992, shqiptarët u bashkuan dhe mposhtën errësirën dhe tiraninë 45-vjeçare, mposhtën diktaturën e së keqes, diktaturën më çnjerëzore që varfëroi, shtypi dhe shkatërroi jetët e miliona shqiptarëve. Është dita e një triumfi të madh të bashkimit të vullnetit të miliona shqiptarëve, por është po kështu edhe një thirrje për një bashkim dhe një zgjim më të madh vullnetesh të shqiptarëve për të mposhtur diktaturën e krimit, për të marrë në dorë fatin tonë dhe për ta çuar Shqipërinë drejt destinacionit të saj hyjnor, mision kombëtar i PD-së, drejt Shqipërisë së lirisë, së dinjitetit, së punës dhe demokracisë evropiane", deklaroi z.Basha. Edhe ish-kryeministri Sali Berisha uroi 22 marsin, ditën e parë të demokracisë kur shqiptarët sipas tij, njerëzit më të shtypur hapën rrugën e ndërtimit të sistemit demokratik. Por ndërsa vlerëson simbolikën e kësaj dite, Berisha shprehet se sot vendi ndodhet në një udhëkryq të rrezikshëm. Ai iu bëri thirrje shqiptarëve të ngrihen dhe të përmbysin, "narkoshtetin e Edvin Ramës dhe klikës së tij". Berisha publikoi edhe një video nga urimi i tij në vitin 1992. "Si sot 26 vite më parë mbi 1.7 milionë të rinj, të reja, burra dhe gra përmbysën me votën tyre të lirë diktaturën e gjenocidit, shtypjes



më të egër dhe krimeve kundër njerëzimit që Shqipëria dhe Europa kishin njohur më parë, diktaturën mizore të Enver Hoxhës, Hitlerit shqiptar të pasluftës. Më 22 mars të vitit 1992 ne nisëm udhëtimin tonë në rrugën e lirisë dhe dinjitetit njerëzor dhe kombëtar, të mbrojtjes së interesit tonë kombëtar dhe çështjes shqiptare të daljes nga izolimi dhe të renditjes së Shqipërisë në anën aleatëve të saj perëndimorë. Si sot 26 vite më parë ne nisëm rrugën e integrimit të vendit në institucionet europiane dhe euroatlantike, Këshillin e Evropës, Bashkimin Europian dhe NATO!", shkruan z.Berisha në 'FB'. Ai shkruan më tej në 'FB' se: "Duke shprehur me nderimin më të madh para të gjithë atyre djemve dhe vajzave, burrave dhe grave që me votën e tyre më 22 mars të vitit 1992 shembën sistemin barbar komunist të Enver Hoxhës, u bëj thirrje shqiptarëve të ngrihemi dhe me guximin tonë të përmbysim, të flakim në koshin e plehrave të historisë narkoshtetin e Edvin Ramës dhe klikës së tij!".

**ASTRIT PATOZI**

Ish-deputeti i PD, Astrit Patozi reagoi dje për 22 marsin, ditën e parë të demokracisë. "Kohët kanë ndryshuar, aq për keq sa jo vetëm nuk duket ndonjë shpresë në horizont për të ardhmen, por për PD-në dhe të djathtën shqiptare po bëhet përherë e më e vështirë t'i gëzohet madje edhe lavdisë së të shkuarës", tha Patozi.

**RIKTHIMI**

"Ndoshta ka ardhur koha që z. Berisha të rikthehet në ballë si e vetmja figurë që mund të mbledhë, bashkojë, koordinojë të djathtën kundër së keqes së madhe. De Gauli shqiptar duhet të kthehet", tha anëtarja e Këshillit Kombëtar të PD-së, Edit Harxhi.

"Figura e vetme që mund të bashkojë të djathtën"

## Harxhi: Të largohet Basha, Berisha të marrë drejtimin e PD

Anëtarja e Këshillit Kombëtar të PD, Edith Harxhi kërkon që të largohet Lulzim Basha dhe Sali Berisha të rikthehet në drejtim e Partisë Demokratike. Përmes një postimi në "Twitter", teksa kujton fitoren e parë të PD në 1992, Harxhi thotë se Berisha duhet të rikthehet në ballë, pasi është se vetmja figurë që mund



të mbledhë dhe bashkojë të djathtën shqiptare. Edith Harxhi thekson se sot PD është më rëndë se kurrë. "Ndoshta ka ardhur koha që z. Berisha të rikthehet në ballë si e vetmja figurë që mund të mbledhë, bashkojë, koordinojë të djathtën kundër të keqes së madhe. De Gauli shqiptar duhet të kthehet. Bacë, kthehu e na prij. Sot është 22 marsi ditë e shënuar e demokracisë tonë, por fatkeqësisht sot PD është më rëndë se kurrë në një kohë që duhej të ngjallte shpresë përkundrejt dhunës politike ekonomike dhe shoqërore të qeverisë aktuale. PD duhet të ringrihet dhe të ndalë krimin dhe korrupsionin", shkruan ajo në "Twitter". Edith Harxhi është një nga kritiket më të forta të kryetarit aktual të PD, Lulzim Basha. Harxhi së bashku me Patozin, Imamin, Topallin, por edhe figura të tjera të PD-së kanë kundërshtuar mënyrën e drejtimit të së djathtës nga Basha dhe procesin e rizgjedhjes në korrik të vitit të kaluar.

"Vendi pa qeverisje, paratë në duart e pushtetarëve"

## 22 marsi, Topalli: Demokracia në rrezik, dilini zot vendit

Ish-deputetja e PD-së, Jozefina Topalli uroi dje 22 marsin, ditën e parë të demokracisë. Ajo e cilëson si ditë të triumfit të demokracisë, por sipas saj edhe pas 26 vitesh, vendi ndodhet sërish në një fazë kritike pa qeverisje dhe pa opozitë. "Pas 26 vitesh shqiptarët po largohen nga shtëpitë e tyre sepse ata nuk shohin dritë në fund të tunelit. Pasuria është përqendruar në pak duar dhe vendimet politike nuk i marrin forcat politike, por vetëm 4-5 titullarë", shkruan Topalli. Ajo përmend se sikur të gjitha këto të mos mjaftonin, në vendin tonë demokracia është në rrezik. "Brenda PD-së, forcës politike që solli votën e lirë, sot nuk ka më zgjedhje, nuk ka më forume, nuk ka më statut,



Ish-deputetja e PD-së, Jozefina Topalli

nuk ka më debat... Të gjitha janë farsë dhe kjo është vetëm njëra anë. Pas 26 vitesh, Lulzim Basha ka zhdukur jo vetëm të djathtën , por opozitën si garancinë kryesore të qytetarëve për t'u dalë zot lirive si dhe të drejtave të tyre ekonomike, politike e sociale. Pas 26 vitesh, Lulzim Basha kërkoi shfuqizimin e 20 shkurtit, datës së rrëzimit të shtatores së diktatorit. Pas reagimeve të forta, projektligji u tërhoq me justifikime tamam si dikur, ku njëri bënte autokritikë të thellë (si dikur në plenume), ndërsa LB si gjithmonë nuk dinte asgjë dhe i habitur për çfarë po dëgjonte, tamam si Pal Vata kur thoshte: Pasha t'madhin zot, unë e Enveri s'dimë gja, në pastë ba Mehmeti, me krye të vet! Sot më shumë se kurrë shqiptarët duhet të bëjnë një reformë të thellë të forcave politike që ata të mos mbeten si pronë e titullarit. Sot më shumë se kurrë interesi publik kërkon që LB të bëjë transparencë për burimet, kanalet e parave të lobimit. Demokratët duhet të ngrihen për t'u dalë zot fëmijëve të tyre, familjes së tyre, partisë së tyre, vendit të tyre", shkruan Topalli në 'FB'.

# SITUATA POLITIKE
## REAGIMET

### Ministria e Brendshme: Vetingu në polici, nis në prill

# Xhafaj në SHBA, takime në DASH: Mbështetje për reformën në drejtësi



Kongresmenët amerikanë vlerësuan dhe shprehën mbështetjen e fortë për reformat impresionuese të qeverisë shqiptare në fushën e drejtësisë dhe sigurisë. Këtë e konfirmoi dje, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Uashington. Gjatë qëndrimit të tij në Uashington, Xhafaj pati një axhendë të ngjeshur takimesh në Departamentin e Shtetit, Kongres, FBI e DEA etj. Në Kongres, fillimisht Xhafaj zhvilloi një takim shumë konstruktiv me kongresmenin Robert B. Anderholt dhe më pas takim me një tjetër mik të Shqipërisë, kongresmenin Steve King. Ndërsa ditën e djeshme, Xhafaj zhvilloi një darkë pune me disa personalitete të njohur për përvojën e tyre si ligjvënës, në fushën e sigurisë dhe diplomacisë, miq e mbështetës në vite të Shqipërisë. "Një diskutim shumë interesant për sfidat aktuale në fushën e sigurisë kombëtare dhe luftën kundër terrorizmit", shkroi Xhafaj në rrjetin social Twitter. Në këtë vizitë në SHBA, Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj shoqërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe një ekip nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit. Ndërkohë pritet që ditët e para të prillit të startojë edhe ngritja e strukturave për realizimin e vetingut dhe nisjes së procesit të rivlerësimit për punonjësit e policisë, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Brendshme. Ministria e Brendshme e ka konsideruar një hap madhor ngritjen e strukturave të vetingut për organizatën e policisë në përpjekjen e saj për garantimin e sigurisë publike dhe luftën ndaj krimit. Pas dekretimit të ligjit nga presidenti dhe me botimin në Fletoren Zyrtare i hapet rruga nisjes së procesit të rivlerësimit për punonjësit e policisë.



### Raporti 13 faqe, zbardhen propozimet e KQZ-së drejtuar Kuvendit, për zgjedhjet e vitit që vjen

# KQZ: Zgjedhjet vendore me sistem proporcional

## *"Të votohet me 1 fletë, të ulet pragu i donacioneve në 150 euro"*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka përcjellë Komisionit të Posaçëm Parlamentar të reformës zgjedhore disa propozime të rëndësishme në lidhje me reformën zgjedhore. Të ndara në disa kategori, në një raport prej 13 faqesh, ku më kryesoret ishin forcimi i sistemit zgjedhor, financimi i partive politike dhe për pasqyrimin e fushatës në media, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve propozon që në zgjedhjet e ardhshme vendore sistemi zgjedhor të jetë proporcional në nivel bashkie, citon Ora Neës. Pra votimi të bëhet me një fletë duke votuar vetëm për partinë dhe jo për kandidatin. "Një sistem zgjedhor proporcional vendor do përforconte efektin dhe do i plotësonte më shpejt objektivat politiko ligjore të sistemit zgjedhor të ri; Një sistem unik votimi për zgjedhjet vendore do të thotë një votim, në vend të dy votimeve që kemi sot, një fletë votimi në vend të dy fletëve". Kjo do të thotë që kryetarin e bashkisë nuk e zgjedhin direkt qytetarët por këshillatrët bashkiakë që përbëjnë shumicën. Qëllimi i kësaj, sipas KQZ është të eliminojë dualitetin e pushtetit Kryetar - Këshill Bashkiak, i cili jo në pak raste është



bërë burim konfliktualiteti ose krizash qeverisje në nivel lokal. "Demokracia vendore në Shqipëri dukshëm ndjen sot nevojën për rritjen e përgjegjësive dhe rolit të këshillave, shndërrimit të tyre në "parlamente" të mirëfillta vendore, si dhe shndërrimin e kryetarëve në 'ekzekutiv" të mirëfilltë, i cili votëbesohet dhe eventualisht humb votbesimin e këshillit". Për sa i përket pasqyrimit të fushatës në media, KQZ rekomandon që Bordi i Monitorimit të Mediave të ngrihet shumë kohë përpara zgjedhjeve për të mos lejuar pasqyrimin e aktiviteteteve elektorale të partive të cilat nisin shumë më herët se 30 ditët e parashikuara. "Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë një formulim të qartë të ndalimit të pasqyrimit në media të veprimtarive me karakter elektoral, jashtë perudhës së fushatës zgjedhore dhe sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve së tyre"., thuhet në material. Në fushatë përfshihet edhe portalet online për të cilat KQZ kërkon që të kenë pronësinë dhe përgjegjësinë ligjore të qartë dhe nëse nuk i kanë, kjo mund të sjellë mbylljen e tyre. Financimi i Partive Politike është një detyrë e vështirë që KQZ e ka të pamundur ta kryjë e vetme. Në rekomandimet e saj, Komisioni kërkon që të ulet pragu i donacioneve që i bëhen partive nga 1 milion lekë të vjetra në 150 euro. "Pragu prej 1 mln lekë është shumë i lartë dhe lë shteg që të pengohet bërja e transparencës së burimeve të financimit nën këtë shumë. Pragu deri në 150 euro, sa paga minimale, i shërben ndjeshëm më mirë nevojës për transparencë që kërkon sot Shqipëria", vijojnë propozimet. Nisur nga problematika e zgjedhjeve të kaluara ku u shkelën të gjitha afatet e regjistrimit të partive politike në zgjedhje, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve kërkon që të rishikohen afatet e regjistrimit të partive për të mos rrezikuar më. Një tjetër propozim lidhet me depolitizimin e komisionerëve partiakë në votim dhe numërim dhe uljen e numrit të grupeve të numërimit nga 4 në 3. KQZ propozon që nëse partitë politike nuk kanë besim tek komisionerët e tyre mund t'i shkarkojnë por pa të drejtë zëvendësimi. Zëvendësimi i tyre do të bëhet nga specialistë të trajnuar që do t'i emërojë KQZ.



### Vizita e papritur në Turqi

## Rama në Stamboll takon Erdogan, bisedon për aeroportin e Vlorës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama është pritur dje, në një takim nga presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, raportoi Anadolu Agency (AA). Dy liderët u takuan në rezidencën presidenciale Tarabya në Stamboll. Sipas axhendës, Edi Rama dhe presidenti turk Erdogan kanë folur për një sërë çështjes ku më e rëndësishmja është ajo e investimeve turke në Shqipëri. Po ashtu, presidenti Erdogan i ka premtuar kryeministrit Edi Rama se do të jetë në Tiranë për përurimin e xhamisë së Namazgjasë. Kryeministri shqiptar, Edi Rama është shoqëruar në këtë vizitë nga bashkëshortja e tij, Linda Rama, siç duket edhe në foton familjare, të publikuar pas takimit. Vetë kryeministri Rama shkroi në Tuitter: "Darkë pune me Presidentin Erdogan për ecurinë e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve; projektet e nisura për aeroportin ndërkombëtar të Vlorës dhe Air Albania; projektet e reja në turizëm dhe energji si dhe mbështetjen e Turqisë për programin tonë të ri kundër përmbytjeve".


Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Rudolf Giuliani gjatë aktivitetit të muxhahedinëve, në Tiranë

## Bushati, dëgjesë në Bundestagun gjerman: Na mbështesni për BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, gjatë vizitës së tij në Republikën Federale Gjermane, përveç takimeve me deputetë gjermanë të partive të ndryshme politike, zhvilloi dhe një seancë dëgjimore në Komisionin Parlamentar për Çështjet e BE-së, me praninë e raportërëve për Shqipërinë në Bundestag. Ministria e Jashtme në një njoftim për mediat sqaron se "Bushati bëri një panoramë të progresit të vendit tonë në fushën e reformave dhe adresimin e pesë prioriteteve kyçe dhe i njohu deputetët me pritshmëritë për hapjen e negociatave për anëtarësim". Bushati i njohu deputetët me ecurinë e reformës në drejtësi, me fokus procesin e vetingut, rezultatet e arritura në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe bashkëpunimin e ngushtë me agjencitë ligjzbatuese të vendeve partnere. Ai përmendi dhe rolin e vendit tonë si faktor stabiliteti në rajon. Nga ana e tij, Kryetari i Komisionit për Çështje të BE-së në Bundestag, Gunther Krichbaum, vlerësoi progresin e bërë nga qeveria shqiptare në adresimin e 5 prioriteteve kyçe, duke evidentuar nevojën për përshpejtimin e zbatimit të reformave të ndërmarra e sidomos asaj në drejtësi, për vetë impaktin e saj në jetën e çdo qytetari shqiptar.

### Këshilltari i Presidentit të SHBA: Kemi marrëdhënie pozitive me Shqipërinë

# Ndikimi rus në Ballkan, Rudy Giuliani: Vrulli për integrimin të përshpejtohet

## "Pranimi i muxhahedinëve tregoi se Shqipëria bëri gjënë e duhur"

Darina Tanushi

Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Rudolf Giuliani, njëherësh edhe këshilltar personal i Presidentit të SHBA-ve, Donald Trump ishte këto ditë në Shqipëri. Ai mori pjesë në një takim të madh të zhvilluar në Pallatin e Kongreseve në Tiranë me muxhahedinët. Giuliani është takuar në kryeqytetin shqiptar me Maryam Rajavi, e cila është drejtuesja e rreth 2 mijë muxhahedinëve që janë strehuar në Shqipëri. Mësohet se ata diskutuan mbi regjimin në Iran dhe nevojën për të adoptuar një politikë vendimtare kundrejt regjimit atje. E pas takimeve që pati në Tiranë, edhe me drejtues të shtetit shqiptar që nga Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama e drejtues të opozitës, Giulini vlerësoi në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" rolin që mbajti Shqipëria duke strehuar muxhahedinët. "Pranimi i MEK-ut tregoi se ky vend ka vlera dhe guxim dhe bën gjënë e duhur në momentin e duhur. Mendoj se ishte shumë e dobishme për Shqipërinë dhe, nga sa pashë, Mek-u ka qenë konstruktiv dhe produktiv gjatë qëndrimit të tij në këtë vend", tha Giuliani. I pyetur në lidhje me ndikimin rus dhe integrimin e Ballkanit, ai u shpreh: "Mendoj se kjo është diçka që duhet ta konsiderojmë të gjithë. Stabiliteti i Ballkanit është i rëndësishëm për Evropën dhe vrulli për integrimin e Ballkanit duhet të vazhdojë dhe të përshpejtohet".

**Z.Giuliani keni ardhur këtu për të vizituar muxhahidët e Iranit në Shqipëri, si është situata e tyre këtu dhe çfarë mund të bëhet për t'i ndihmuar ata?**

Prania e tyre në Shqipëri ishte një hap i madh drejt garantimit të sigurisë së tyre. E di që regjimi iranian po përpiqet t'i dëmtojë në mënyra të ndryshme, duke përfshirë edhe fushatën e dezinformimit. Pra, mendoj se është e rëndësishme të sigurohemi që regjimi iranian apo agjentët e tij nuk do të jenë në gjendje të veprojnë në këtë vend. Kjo është gjithashtu në interes të Shqipërisë dhe mund t'ju them se do të ishte në përputhje me këndvështrimin e Qeverisë së SHBA-ve, duke qenë se administrata amerikane e sheh regjimin iranian si një kërcënim të madh.

**Ju e njihni MEK-un për vite me radhë. Keni qenë mbështetës aktiv i kauzës së lirisë dhe demokracisë në Iran. Cila është përshtypja juaj për ta dhe në veçanti për znj.Maryam Rajavi, presidente e zgjedhur e Këshillit Kombëtar të Rezistencës së Iranit, përbërësi kryesor i të cilit është MEK-u?**

Ata janë njerëz shumë të përkushtuar. Janë shumë të arsimuar dhe besojnë në parimet e rëndësishme që vlerësohen nga e gjithë bota moderne dhe e lirë si, liria e fjalës, liria e asocimit, liria e fesë, barazia gjinore dhe gjithashtu një Iran jobërthamor. Ata luajtën një rol kyç në zbulimin e programit sekret të ajatollahëve për t'u pajisur me armë bërthamore. Kanë vuajtur shumë dhe kanë paguar një çmim të rëndë duke iu kundërvënë ajatollahëve. Gjatë viteve, më shumë se 100,000 prej tyre janë vrarë nga ky regjim, i cili është një shtet totalitar dhe numri një për sponsorizimin e terrorizmit në botë. E njoh personalisht znj. Rajavi që prej gati 10 vjetësh. Është një grua shumë e kulturuar dhe e arsimuar, që përkrah një Islam tolerant. Ajo ka treguar një lidership të jashtëzakonshëm gjatë viteve në udhëheqjen e rezistencës për liri. Admiroj vendosmërinë dhe bindjen e saj. Përgjatë viteve kam vërejtur se mbështetja ndaj lëvizjes së saj është rritur. Çdo vit ata organizojnë një tubim të madh në Paris, ku marrin pjesë më shumë se 100,000 njerëz nga e gjithë bota.

**Mendoni se në SHBA është rritur mbështetja për MEK-un dhe kauzën për ndryshimin e regjimit në Iran?**

Po. Kam vërejtur një mbështetje në rritje mes politikanëve dhe sidomos në Kongres. Në mënyrë shumë interesante, kauza e tyre për vendosjen e lirisë dhe demokracisë në Iran ka mbështetje dypartiake në SHBA, gjë që është shumë e veçantë në këto ditë. Dhe mendoj se me kalimin e kohës, më shumë njerëz po e kuptojnë se bërja e një marrëveshjeje me ajatollahët, sikurse bëri administrata jonë e mëparshme, ishte një gabim i madh dhe ne duhet të mbështesim politikisht dhe moralisht ndryshimin e regjimit nga vetë populli iranian. MEK-u ka treguar se ka mbështetje të mirë popullore në Iran.



Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Rudolf Giuliani gjatë aktivitetit të MEK

**MEK**

"Pranimi i MEK-ut tregoi se ky vend ka vlera dhe guxim dhe bën gjënë e duhur në momentin e duhur. Mendoj se ishte shumë e dobishme për Shqipërinë dhe, nga sa pashë, Mek-u ka qenë konstruktiv dhe produktiv gjatë qëndrimit të tij në këtë vend. Pra, të gjithë përfituan nga prania e tyre dhe nga mirëpritja këtu", u shpreh Giuliani.


Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Rudolf Giuliani gjatë intervistës për "GSH"

**RAPORTET ME SHBA**

"Mendoj se kemi një marrëdhënie shumë pozitive me Shqipërinë. Ne e vlerësojmë këtë marrëdhënie. Ka qenë e tillë për vite me radhë. Shqipëria ka qenë një aleate e ngushtë dhe jam i sigurt se do të vazhdojë kështu", tha këshilltari i Trump.

**Regjimi iranian është shumë i ashpër ndaj MEK-ut dhe jo vetëm që i vret ata në Iran, por gjithashtu i ka shndërruar në objektiv të një dezinformimi masiv dhe sulmeve të egra nga ana e Teheranit. Pse mendoni se Teherani është kaq i fokusuar te MEK-u?**

Arsyeja është shumë e thjeshtë. Ata paraqesin një kërcënim serioz ndaj ajatollahëve. Me gjithë vrasjet dhe vuajtjet, ata jo vetëm kanë mbijetuar, por po ashtu janë rritur. Kjo është arsyeja pse ajatollahët vazhdojnë të flasin dhe të shprehin shqetësimet e tyre për ta. Ishte mjaft treguese që në mes të protestave të mëdha, Hassan Rouhani, presidenti i ajatollahëve, telefonoi Presidentin francez dhe u ankua për rezistencën dhe rolin që luan znj. Rajavi. Ishte mjaft treguese për ndikimin e opozitës brenda Iranit. Duke pasur parasysh të gjitha krizat me të cilat përballen ajatollahët, është e kuptueshme që ata bëjnë diçka për të diskredituar opozitën e tyre. Por po bëhet gjithnjë e më pak efektive.

**Cila është përshtypja juaj për protestat e mëdha në Iran? A mendoni se kjo ishte një thirrje për zgjim të shumë njerëzve në perëndim se regjimi i ajatollahëve është i dobët dhe i urryer brenda vendit nga iranianët? A mendoni se SHBA duhet të bëjë presion për sanksione më të ashpra ndaj Iranit dhe t'i japë më shumë mbështetje morale dhe politike opozitës?**

Mendoj se treguan qartë se populli iranian është i ngopur me regjimin. Ai do liri, do demokraci. Ai nuk beson në fantazinë e të moderuarve dhe në ndryshimin nga brenda këtij regjimi. Fakti se ka pasur protesta në më shumë se 100 qytete dhe fshatra dhe burra e gra nga të gjitha shtresat e shoqërisë marrin pjesë dhe këndojnë kundër udhëheqësit supremë, e bën të qartë se ai do ndryshimin e regjimit dhe është i gatshëm të paguajë çmimin. Mendoj se iu dërgua një mesazh i qartë Perëndimit se bërja e biznesit me ajatollahun është e gabuar dhe ai duhet të ikë. Mendoj se janë shumë të nevojshme më shumë sanksione për shkak të veprimtarive të këqija dhe të neveritshme të ajatollahut në Iran dhe jashtë Iranit. Ne duhet të jemi në anën e popullit iranian për ndryshimin e regjimit nga ana e popullit iranian, sikurse bëri presidenti dhe nënpresidenti ynë gjatë protestave dhe mendoj se duhet të shkojmë edhe më tej.

**Jeni në një nga vendet më proamerikane në botë. Shqipëria është aleate e SHBA në luftën kundër terrorizmit. Shqipëria gjithashtu shtoi praninë e saj në Afganistan. Si e vlerësoni marrëdhënien midis dy vendeve?**

Mendoj se kemi një marrëdhënie shumë pozitive me Shqipërinë. Ne e vlerësojmë këtë marrëdhënie. Ka qenë e tillë për vite me radhë. Shqipëria ka qenë një aleate e ngushtë dhe jam i sigurt se do të vazhdojë kështu.

**Mendoni se pranimi i MEK-ut në Shqipëri ndihmoi imazhin e Shqipërisë në botë në përgjithësi dhe në SHBA në veçanti?**

Vërtet që ndihmoi imazhin e Shqipërisë në SHBA. Kam dëgjuar të njëjtën gjë nga shumë miq të mi evropianë. Pranimi i MEK-ut tregoi se ky vend ka vlera dhe guxim dhe bën gjënë e duhur në momentin e duhur. Mendoj se ishte shumë e dobishme për Shqipërinë dhe nga sa pashë, Mek-u ka qenë konstruktiv dhe produktiv gjatë qëndrimit të tij në këtë vend. Pra, të gjithë përfituan nga prania e tyre dhe nga mirëpritja këtu.

**Flitet për praninë dhe ndikimin e Rusisë në rajonin e Ballkanit. A mendoni se SHBA dhe Evropa mund të bëjnë më shumë për të përshpejtuar integrimin euroatlantik të rajonit?**

Mendoj se kjo është diçka që duhet ta konsiderojmë të gjithë. Stabiliteti i Ballkanit është i rëndësishëm për Evropën dhe vrulli për integrimin e Ballkanit duhet të vazhdojë dhe të përshpejtohet.

KONCESIONET
PPP-të

Zbardhen kontratat koncesionare dhe të Partneritetit Publik Privat

# Pronat publike në duar të privatit, vlera deri 504 miliardë lekë

## Marrëveshjet disavjeçare nga rrugët, te laboratorët, HEC-et etj.

Ornela Manjani

Shteti shqiptar ndër vite ka transferuar pronat publike në duar të privatit përmes dy mënyrave, dhënie me koncesion, ose Partneritet Publik Provat. Marrëveshjet disavjeçare arrijnë 223 kontrata koncesionare dhe të Partneritetit Publik Privat me një vlerë prej 504,8 miliardë lekësh. Ndërsa për vitin 2018 janë 8 kontrata të reja. Në total këto kontrata e kanë faturën 661,594,257,243 lekë. "Open Data Albania" ka hulumtuar mbi kontratat koncesionare apo të Partneritetit Privat Publik, të cilat janë lidhur ndër vite. Hulumtimi bazohet tek të dhëna për kontratat apo marrëveshjet koncesionare sipas një evidentimi të bërë në dokumentin Relacioni për Projektbuxhetin e Shtetit 2018. Kontratat janë ndarë sipas sektorëve ekonomikë. "Sipas Open Data", kontratat koncesionare dhe PPP apo marrëveshjet janë mjaft dinamike. Vlerat e parashikuara janë të lidhura me efekte realizimi dhe mosrealizimi, sikurse me efekte të ndryshimeve shtesave apo riformulimeve që u bëhet kontratave. Gjithashtu, këto lloj kontratash kanë një shtrirje të gjatë në kohë dhe shpesh regjime apo referenca ekonomike të tregut sjellin ndryshime të mundshme në parashikime dhe realizime të kontratës. Referuar hulumtimit të "Open Data", sektori i energjisë dominon kontratat në fjalë me 75% të totalit të vlerës. Në total, ky sektor numëron 185 nga 223 kontrata me një vlerë prej 379.4 miliardë lekësh. Të gjitha kontratat koncesionare të këtij sektori janë të llojit ndërtim, operim dhe transferim/mirëmbajtje hidrocentrali. Kontrata me peshën më lartë ndaj totalit të vlerës së këtij sektori është kontrata koncesionare e ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali, kaskada e Devollit, me një vlerë prej 130 miliardë lekësh.

Sektori i dytë me peshë më të lartë për sa i përket vlerës së kontratave është transporti me 7 për qind të totalit të vlerës së kontratave, apo 37.5 miliardë lekë. Ky sektor numëron 14 kontrata koncesionare të ndara sipas llojit në tri kontrata shërbimesh dhe 11 kontrata të ndërtimit, operimit dhe transferimit. Kontrata me vlerën më të lartë në këtë sektor është ndërtimi, operimi dhe transferimi i aeroportit "Nënë Tereza", me një vlerë prej 9.3 miliardë lekë. Kontrata e dytë me vlerë më të lartë në këtë sektor është kontrata e ndërtimi, operimi dhe transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese me një vlerë prej 7 miliardë lekë. Kjo kontratë realizohet me mbështetje nga buxheti i shtetit.

Sektori i shëndetësisë është sektori i tretë me peshën më të lartë për sa i përket vlerës së kontratave të këtij sektori ndaj totalit të shumës së të gjitha kontratave. Të gjitha kontratat e këtij sektori janë me mbështetje buxhetore. Në sektorin e shëndetësisë janë lidhur katër kontrata shërbimesh: ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale, shërbimi i hemodializës, ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up), ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore. Në total vlera e koncesioneve e këtij sektori llogaritet 34.2 miliardë lekë.

Sektori i tatimeve dhe dogana ka një faturë koncesionare prej 28.1 miliardë lekë. Ky sektor numëron dy kontrata shërbimesh: financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë me vlerë 27.6 miliardë lekë. Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve me vlerë 475 milionë lekë.

Sektori i mjedisit ka lidhur kontrata me vlerë 25.4 miliardë lekësh. Ky sektor ka tri lloje kontratash të lidhura: një kontratë shërbimesh menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjorë, arror në fidanishten shtetërore të Cërrikut, Elbasan; tri kontrata të llojit ndërtim, operim dhe mirëmbajtje, të cilat marrin mbështetje nga buxheti i shtetit. Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunuar të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan. Për ndërtimin e administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë, inceneratori i Tiranës dhe një kontratë koncesionare shfrytëzimi: shfrytëzimi i burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë. Inceneratori i Tiranës ka vlerën më të lartë të këtij sektori prej 18.3 miliardë lekësh dhe është një kontratë që do të marrë mbështetje nga buxheti i shtetit.

Sektori i bujqësisë është sektori me më pak peshë për sa i përket faturës koncesionare me vlerë prej 1.9 milionë lekë. Lloji i kontratës së lidhur është ndërtim, operim, transferim për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, në Kavajë.

### KONTRATAT E REJA

Kontratat e reja
Për vitin 2018 janë parashikuar 8 kontrata të reja koncesionare të ndarë sipas sektorëve: 1 në sektorin e arsimit, 1 në sektorin e shëndetësisë dhe 6 në sektorin e transportit. Në sektorin e arsimit parashikohet ndërtimi me koncesion i 17 shkollave në Bashkinë Tiranë me një vlerë prej 6.4 miliardë lekë. Ndërtimi, operimi, transferimi i Spitalit Rajonal Fier me koncesion ka një vlerë prej 9.5 miliardë lekësh. Në sektorin e transportit për 2018-ën parashikohen të fillojë ndërtimi me koncesion për këto projekte: ndërtimi dhe operimi i aksit Tiranë-Thumanë-Vorë, ndërtimi dhe operimi i rrugës Kardhiq-Delvinë, ndërtimi dhe operimi i rrugës Kashar-Rrogozhinë, ndërtimi dhe operimi i rrugës Milot-Balldren, ndërtimi dhe operimi i rrugës Orikum-Himarë, ndërtimi dhe operimi i Rrugës së Arbrit.

### KONTRATAT KONCESIONARE NE SEKTORIN E ENERGJISË SIPAS VLERAVE

| | Vlera e kontratës ne leke |
|---|---|
| | 379,478,818,639 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Kaskada e Devollit | 130,000,000,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim të Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit | 30,994,337,216 |
| Ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit të ri në Ashta | 19,520,000,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dukagjini 1 2 3 | 18,876,907,000 |
| Ndërtim, Operim, Transferim i hidrocentralit Poçem | 14,134,724,113 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë | 13,728,387,330 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali mbi lumin Fan i Madh dhe Fan i Vogël ( 5 hec-e: gojan, gjeg | 13,600,000,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim Hec-et mbi lumin Gostime | 7,806,058,026 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Valbona | 7,331,612,960 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi lumin Shkumbin (9 hece-QUKES) | 6,249,092,892 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Zalli i Qarrishtes | 5,273,943,244 |
| Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5 | 4,547,551,449 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit | 4,443,351,400 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zen | 4,069,596,314 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtri | 3,673,402,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjost i Ri; Ble1, 2; Topojan 1,2 | 3,565,744,707 |
| Për ndërtimin, operim dhe transferim të Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sllove dhe Bjeshke | 3,254,323,134 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1 | 3,181,563,000 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Begaj | 2,794,366,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Shushice | 2,433,789,054 |
| Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia | 2,404,858,492 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3 | 2,273,383,994 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4 | 2,149,411,466 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2 | 1,980,904,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë | 1,884,040,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi | 1,725,593,333 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Vlushe | 1,715,320,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim Hidrocentralet mbi përroin | 1,702,149,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi Lumin Gjadër | 1,592,690,975 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë | 1,572,169,360 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2 | 1,512,585,536 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Grabova 2 | 1,486,571,351 |
| Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimin e Hidrocentr | 1,465,039,743 |
| Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lapaj | 1,453,500,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin SETA | 1,400,805,550 |
| Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3 | 1,300,177,500 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë | 1,290,117,487 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dars | 1,230,440,516 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Seke | 1,177,887,502 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Shmilit dhe Zallit të G | 1,165,964,018 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Staravecka (Backa 1,.2,3) | 1,156,808,769 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3 | 1,084,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas | 1,042,888,000 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq | 1,041,453,039 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg | 995,034,550 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4 | 971,365,040 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Denas | 936,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bënçë e Sipërme | 929,146,830 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë. | 907,956,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Stavec | 870,315,194 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh | 857,861,985 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Sllabinje 2 | 847,000,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJ | 837,404,386 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1 | 830,097,322 |
| Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B | 815,963,996 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Guri i Bardhe | 800,908,292 |
| Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4 | 790,361,250 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Lunik | 786,900,000 |
| Ndërtimin, operimin dhe tranfesrimin e Hidrocentraleve Gjuraj, Kashec, Ragam dhe Lepurushe | 780,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4 | 756,400,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Rapuni 1, Rapuni 2 | 749,080,000 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Kaskada e Luses | 743,776,400 |

| | |
|---|---|
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bënçë dhe Tepelenë | 675,221,200 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2 | 671,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës | 656,545,309 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterë dhe Fterë 1. | 650,565,750 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Lusa | 621,368,362 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2 | 587,975,273 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizës/Vajkal- Rreth | 587,563,575 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3 | 577,625,340 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit | 567,859,875 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës | 526,318,254 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin | 521,573,382 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Bushtrica 1 | 506,147,190 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj | 503,529,364 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferim te hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2 | 501,411,750 |
| Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan | 500,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3 | 497,257,690 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi përroin Sheja e Librazhdit 5 hidrocentrale | 492,775,800 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit KALIVAR | 465,326,140 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Hotolisht, Librazhd | 424,080,723 |
| Ndërtim, operim dhe transferim e hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4 | 416,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1 | 392,862,289 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Batra | 369,786,250 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Suha 2 | 360,000,000 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë | 354,282,240 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit RUNJA | 351,244,805 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjun | 349,864,502 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5 | 348,238,001 |
| Ndërtim, operim, trensferim i hidrocentralit Labinot Fushë | 347,706,122 |
| Ndërtim, operim dhe transferim, i Hidrocentraleve, Prishta1, Prishta 2, | 329,256,843 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Tervol | 325,800,167 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve të Lashkizës | 322,691,040 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Egnatia | 321,956,600 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë. | 315,570,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Kaçinar | 315,219,168 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A | 311,332,059 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit | 309,815,533 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3 | 300,673,715 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4 | 295,860,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali HEC-et ne pellgun ujëmbledhës te përroit Malind | 294,085,200 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Potam | 291,900,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop | 283,950,430 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Valbone | 274,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltanj | 273,892,660 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Selca 2 dhe Mesmal | 269,981,177 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit LLËNGË | 252,559,542 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bershi-Klos | 250,548,894 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2 | 250,000,000 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit ARSTI | 225,125,130 |
| Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MË | 223,087,239 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë | 216,152,500 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Nishan | 212,520,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë | 209,336,441 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3 | 208,659,212 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3 | 200,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1,2 | 199,921,096 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit VILIQ | 199,260,305 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi përroin e Truenit | 192,560,000 |
| Për ndërtimin operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku | 188,055,946 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë | 188,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2 | 176,738,773 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Malla | 176,321,017 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ | 175,585,602 |
| Ndërtim. operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2 | 166,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gavran1 dhe Gavran | 164,333,245 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Steblevë | 159,680,320 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza | 151,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Quki 1 dhe Quku 2 | 150,894,676 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Lingjaca | 149,524,860 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III | 144,560,000 |
| Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2 | 144,554,509 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shutri | 139,666,667 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë | 138,314,960 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Guri i Kuq 1/1 dhe Guri i Kuq 1/2 | 136,963,790 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Shutri 1,2 | 136,783,700 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2 | 134,550,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni | 133,121,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5 | 131,064,360 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë | 129,541,704 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Topcias (Rrethi Elbasan) | 128,221,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bregu i Madh | 128,136,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Stojan | 124,333,623 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas, Bracen, Kuç | 124,254,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2 | 123,858,465 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj | 123,761,020 |
| Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentralit ZEREC | 120,311,959 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë | 120,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C | 115,680,876 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë | 115,000,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2 | 108,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar | 106,780,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj | 102,963,375 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shënjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë | 101,242,260 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos | 96,422,100 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOC | 92,548,781 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2 | 89,684,218 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4 | 87,570,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshtun, Rrethi Dibër | 86,818,382 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Zalle Xhuxh 1,2 | 85,780,000 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Marshove | 83,500,000 |
| Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Skatharë | 80,070,750 |
| Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj | 79,700,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mgulle | 69,026,908 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Cangonj | 62,650,250 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Përroin Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës | 61,916,210 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzezë | 51,955,070 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj | 51,434,808 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak | 50,617,908 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm | 50,419,481 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë | 49,800,000 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël | 46,870,792 |
| Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2 | 46,315,030 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Blaç | 44,000,032 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje | 42,420,000 |
| Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dragostunje | 39,000,000 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Lubonjë | 39,000,000 |
| Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Ko | 37,250,000 |
| Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1 | 35,455,750 |
| Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit QYTEZË | 27,700,000 |
| Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Dishnicë | 15,300,000 |
| Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal" | 12,500,000 |
| Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit DOMAJ, Has | 12,369,610 |

## KONTRATAT KONCESIONARE NE SEKTORIN E TRANSPORTIT

| | Vlera e Kontratave |
|---|---|
| | **1,354,539,000** |
| Menaxhimi, Operimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi teknik dhe Adaptimi i terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës. | 555,162,000 |
| Projektim, financim, rehabilitm, testim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve. | 561,003,000 |
| Dhënie me koncesion të shërbimeve detare.(ASHD), | 238,374,000 |
| | **36,158,819,873** |
| Menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të konteinerve në portin e Durrësit | 3,705,000,000 |
| Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin | 730,338,000 |
| Ndërtimi i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë. | 4,450,000,000 |
| Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit "Nënë Tereza" | 9,310,000,000 |
| Ndërtimi, Operimi, Transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë | 1,937,932,800 |
| Ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë | 2,005,314,422 |
| Ndërtimi, shfrytëzimi i portit të jahteve në qytetit e Durrësit. (BOT) | 1,356,144,750 |
| Ndërtimi, Shfrytëzimi dhe Transferimi të portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës | 1,162,800,000 |
| Operimi, Ndërtimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi Teknik dhe Adaptimi i Terminalit Lindor Durrës. | 2,069,371,737 |
| Ndërtim, operim dhe transferim Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë | 2,431,918,164 |
| Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese | 7,000,000,000 |
| | |
| | 37,513,358,873 |

## KONTRATA NE SEKTORIN E SHENDETESISE

| | Vlera ne leke |
|---|---|
| | |
| Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale. | 10,055,472,000 |
| Shërbimi i Hemodializës | 8,706,600,000 |
| Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up) | 6,435,520,000 |
| Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore | 9,058,000,000 |
| | |
| | 34,255,592,000 |

## KONTRATAT KONCESIONARE SEKTORI I MJEDISIT

| | Vlera e kontratave ne leke |
|---|---|
| | **49,660,000** |
| Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan | 49,660,000 |
| | **24,935,343,761** |
| Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunuar të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan | 2,894,400,000 |
| Për ndërtimin e administrimin e Impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë | 3,666,177,561 |
| Inceneratori i Tiranes | 18,374,766,200 |
| | **503,712,646** |
| Shfrytëzimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë | 503,712,646 |
| | 25,488,716,407 |

## KONTRATAT NE SEKTORIN TATIMOR DHE DOGANOR

| | Vlera e kontratave (lek) |
|---|---|
| Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë. | 27,663,364,824 |
| Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve | 475,380,000 |
| | 28,138,744,824 |

## KONTRATAT KONCESIONARE NE SEKTORIN E BUJQËSISË

| | |
|---|---|
| Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë | 1,906,500 |

## KONTRATA TE PARASHIKUARA PËR VITIN 2018

| | | Kontratat ne vlere (lek) |
|---|---|---|
| **Ndërtim, Operim, Transferim** | | **6,440,000,000** |
| | *Ndërtimi i Shkollave ne Arsimin Parauniversitar ne Bashkinë e Tiranës* | 6,440,000,000 |
| **Ndërtim, Operim, Transferim** | | **9,598,120,000** |
| | *Spitali Rajonal i Fierit* | 9,598,120,000 |
| **Ndërtim, Operim, Transferim** | | **140,679,000,000** |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Aksit Tirane-Thumane-Vore* | 34,307,000,000 |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Kardhiq - Delvine* | 8,652,000,000 |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Kashar - Rrogozhine* | 41,580,000,000 |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren* | 14,280,000,000 |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Orikum - Himare* | 17,808,000,000 |
| | *Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës se Arbrit* | 24,052,000,000 |
| | | |
| | | 156,717,120,000 |

Indeksi, vështirësohet klima, ndikuan taksat, monopolet dhe konkurrenca e pandershme

# Dhoma Amerikane: Rriten taksat, bie konkurrenca. Lu: Jam i zhgënjyer

## *Raporti: Të shqetësuar për nivelin e taksave dhe burokracitë*

Ornela Manjani

Indeksi i Biznesit të Dhomës Amerikane, një tregues që publikohet çdo vit dhe mat perceptimin e anëtarëve lidhur me ambientin për të bërë biznes në Shqipëri është përkeqësuar sërish këtë vit, pas përmirësimit të vitit të kaluar. Sipas rezultateve zyrtare, Indeksi i Biznesit ka shënuar një ulje të lehtë prej 1.33 pikësh, nga 43.78 në vitin 2016 në 42.45 në vitin 2017. Anëtarët e Dhomës Amerikane mbeten të shqetësuar për nivelin e taksave, burokracinë qeveritare, monopolet dhe konkurrencën e pandershme, gjetjen e stafeve të kualifikuara vendëse dhe nivelin e informalitetit. Pasi është njohur me raportin, ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, është shprehur i zhgënjyer në lidhje me klimën në të cilën operon biznesi amerikan në vendin tonë. "Jam i zhgënjyer të shikoj se Indeksi i Dhomës Amerikane në vitin 2017 ka rënë lehtë, në 42.45, nga 43.78 në 2016-n". Me këtë frazë drejtohet ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Lu, në letrën e tij për anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë, të cilën z.Lu e lexoi të plotë para anëtarëve të Dhomës mbrëmjen e djeshme, kur u prezantuan rezultatet e indeksit. "Ashtu si në vitet e kaluara, ABI për vitin 2017 reflekton pakënaqësinë e vazhdueshme me një sërë treguesish të rëndësishëm të klimës së biznesit, veçanërisht nivelet e taksave, burokracinë e qeverisë, konkurrencën e pandershme, problemet në gjetjen e stafit të kualifikuar dhe korrupsionit", - thuhet në letrën e ambasadorit. "Sondazhi - thuhet në letër - gjithashtu tregon se besimi i anëtarëve është përmirësuar në disa fusha, përfshirë kërkesën për mallra dhe shërbime, furnizimin me energji dhe gjendjen e sistemit gjyqësor. Ulja e lehtë e indeksit këtë vit konfirmon se mbetet ende shumë për t'u bërë, për të përmirësuar klimën e biznesit në vend. Legjislacioni, taksat dhe sistemet rregullatore duhet të nxisin një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të drejtë. Unë jam i inkurajuar nga misioni i Dhomës Amerikane për të ndërtuar një klimë më të mirë biznesi. Së bashku ne mund të nxisim qeverinë që të zbatojë reformat e nevojshme dhe të luftojë korrupsionin. Unë u kërkoj të gjithë anëtarëve të Dhomës Amerikane të kërkojnë të mbajnë lart vlerat bazë amerikane të drejtësisë dhe transparencës. Së bashku, ne mund të tejkalojmë sfidat e momentit dhe të punojmë për një qëllim më të madh, të bazuar në interesat tona të përbashkëta dhe vlerat që ndajmë", përfundon letra e ambasadorit.



Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu

**RAPORTI**

Anketimi i zhvilluar për Indeksin e Biznesit tregon se një perceptim aspak pozitiv që kanë pasur bizneset anëtare të Dhomës Amerikane gjatë vitit 2017 edhe për klimën e brendshme politike, e cila ka rënë me 5.08 pikë, si dhe për sigurimë në vend që ka pësuar rënie me 2.37 pikë. Dhoma Amerikane e Tregtisë njofton se ka organizuar zgjedhjet për zëvendëspresident, përgjegjës për Thesarin dhe sekretar, si dhe për një anëtar bordi, duke sjellë kështu katër anëtarë të rinj në bord. Ky proces ka përfshirë në konkurrim dhjetëra kompani prestigjioze të Dhomës dhe një shumicë të ndjeshme të kompanive amerikane. Me vendim të bordit të Dhomës dhe më pas me miratim në asamble, Dhoma Amerikane ka bërë disa ndryshime në statut, të cilat ulin numrin e anëtarëve të bordit të Dhomës nga 11 anëtarë në 7 anëtarë, si dhe ulin numrin e mandateve për çdo anëtar bordi dhe të kompanive që ata përfaqësojnë nga tri në dy mandate të njëpasnjëshme. Rezultatet e Indeksit të Biznesit 2017-2018 janë prezantuar në asamble me të gjithë treguesit që matin besimin që kanë kompanitë anëtare të Dhomës Amerikane në lidhje me parametrat kryesore të klimës së biznesit.

### Tarifat e telefonisë celulare

## AKEP: Kompanitë duhet të lajmërojnë 20 ditë para për ndryshimet

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka vendosur të ndërhyjë në rregulloren e vitit 2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike". Në draftin e nxjerrë për konsultim, AKEP ka bërë të paktën tri shtesa. Së pari, në nenin 6 të saj ku renditet në 11 pika lloji dhe përmbajta e informacionit është vendosur të shtohet një pikë e re, ku thuhet se "sipërmarrësit duhet të publikojnë dhe të vënë në dispozicion të pajtimtarëve informacionin e plotë mbi cilësitë e shërbimit sipas nenit 102 të Ligjit". Bëhet fjalë për ligjin 9918 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar për herë të fundit në vitin 2013. Në nenin 102 thuhet: "Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të publikojnë informacionin e duhur, të krahasueshëm dhe të përditësuar për cilësinë e shërbimeve të ofruara prej



tyre dhe për masat e marra për të garantuar akses të barabartë për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara. AKEP-i, në bazë të një rregulloreje të veçantë, përcakton treguesit e cilësisë së shërbimit". Një tjetër ndryshim është ai në nenin 8 për detyrimin e informimit të AKEP. Në këtë nen është vendosur për herë të parë afati para të cilit duhet të njoftohet rregullatori nga kompanitë e tregut për ndryshimin e tarifave. Kështu, sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi mënyrën e publikimit të tarifave dhe shërbimeve dhe çdo ndryshim të tyre jo më vonë se 20 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave ose ndryshimeve. "Informacioni mbi tarifat, shërbimet dhe ofertat shoqërohet me referencat si vijon: a. duke dhënë linkun përkatës në faqen e internetit se ku janë publikuar tarifat dhe informacioni për to, b. duke përfshirë fletëpalosjet përkatëse të programit të ri tarifor, c. mjetet e informimit publik ku është bërë njoftimi i tyre", thuhet në dokumentin e AKEP.

### Tatimet, në "aksion" për arkëtimin e borxheve të biznesit

## Verifikim saktësisë së kuponëve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën të ditur se ka organizuar mbledhjen e "Komitetit Operacional" nr.11 për "Miratimin e Planit Operacional për periudhën prill - maj 2018", të Drejtorisë së Hetimit Tatimor. Ky plan është hartuar në funksion të parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të evazionit fiskal dhe paligjshmërisë në fushën e tatimeve. Zbatimi i tij do të shtrihet në të gjithë territorin e vendit, duke pasur si objekt kryesor: arkëtimin e borxheve të kri-



juara, tatimpaguesit aktive që kalojnë në status pasiv, si pasojë e ndryshimit të përgjegjësisë tatimore, verifikimin e subjekteve për lëshimin e kuponit tatimor në vlerën reale të produktit/shërbimit krahasuar me listën e afishuar të çmimeve. Gjithashtu, në fokus të punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor për këtë periudhë do të jenë edhe subjektet që janë të angazhuara në realizimin e punëve publike. Ndërsa, në sektorin e ndërtimit, kontrollet do të përqendrohen në verifikimin e gjendjes aktuale, si dhe në verifikimin e numrit të punonjësve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbetet e angazhuar për të nxitur të gjithë tatimpaguesit që të përmbushin në mënyrë vullnetare të gjitha detyrimet ligjore, por edhe të denoncojnë akte të abuzimit nga ana e administratës tatimore.

"Nuk është hera e parë që lojtari tregon agresivitet, të përjashtohet nga ekipi"

# Sulmohet trajneri i Tiranës U-17, arrestohet babai i futbollistit

Ina Allkanjari

## *Migen Memelli: Nuk i futa në lojë djalin që është kapiten skuadre, më goditi me grushte*





Trajneri i U-17 Tiranë, Migen Memelli

Patëm një ndeshje miqësore dhe kapitenin e skuadrës vendosa ta lë pushim pjesën e parë, për ta aktivizuar pjesën e dytë. U mërzit dhe u largua në formë proteste nga ndeshja dhe lajmëroi prindin e tij. Në kohën që po fusja skuadrën në fushë, erdhi babi i futbollistit dhe filloi të më ofendonte dhe më goditi 4 herë. Më pas tentoi të më godasë me thikë, por u largova". Kështu është shprehur në një prononcim ekskluziv për "Gazeta Shqiptare" trajneri i para të rinjve të Tiranës, Migen Memelli, i cili ka rrezikuar të goditet me thikë pranë qendrës stërvitore të skuadrës së tij. Policia bën me dije se autori i sulmit është 47-vjeçari Abdyl Çeku, prindi i një lojtari të ekipit U-17 të Tiranës, i cili sulmoi me grushte trajnerin e U17 gjatë një ndeshje miqësore pranë fushës sportive "Skënder Halili" në kryeqytet. Më tej Memelli tregoi se ishte ndërhyrja e një trajneri tjetër dhe disa futbollistëve ajo çka qetësoi situatën. Gjithashtu, ai tregoi se menjëherë pas ngjarjes është paraqitur në polici ku ka dëshmuar për incidentin. "Pas dhunës fizike të ushtruar ndaj meje, ishte ndërhyrja e trajnerit të ekipit tjetër dhe disa futbollistëve nga ekipi i të rriturve, që çoi në stepjen e zotërisë. Ai mori djalin dhe u largua. Më pas u paraqita në komisariatin numër 6 dhe depozitova një kallëzim penal që të merren masat e duhura",- u shpreh trajneri Memelli. Ndërkohë burime zyrtare nga policia e Tiranës bëjnë me dije se në përfundim të veprimeve hetimore kanë vënë në pranga 47-vjeçarin Çeku për veprën penale "Kanosje për shkak të detyrës". Trajneri i U-17 të Tiranës thekson gjithashtu se futbollisti Çeku është kapiteni i skuadrës dhe nuk mund të tolerohen sjellje të tilla. Ai bën thirrje që klubi i Tiranës të marrë masat e duhura për përjashtimin e të riut. "Djali, i cili u bë problem, është kapiteni i skuadrës dhe është trajtuar më mirë se kushdo tjetër. Shpresoj që klubi të marrë masat e duhura dhe ai të përjashtohet nga klubi i Tiranës. Nuk mund të mbajmë njerëz të padisiplinuar dhe arrogant. Nuk është hera e parë që një incident i tillë ndodh me këtë person. Më herët e ka përjashtuar trajneri i kombëtares U-17, ka debatuar me trajnerë të tjerë më përpara, dhe tashmë ndodhi incidenti me mua",-tregon Memelli. Sakaq menjëherë pas ngjarjes ka reaguar edhe klubi i futbollit të Tiranës, duke dënuar ashpër incidentin dhe ka premtuar se do të marrë masa për të mbajtur larg fushave sportive prindërit e dhunshëm. "KF Tirana dënon ashpër incidentin e ndodhur sot në kompleksin stërvitor "Skënder Halili". Dhuna verbale dhe fizike e ushtruar ndaj trajnerit të Tiranës U17, nga prindi i një futbollisti ndaj Migen Memellit meriton dhe do të dënohet. Klubi ka marre menjëherë të gjitha masat për të mbështetur trajnerin Migen Memelli. KF Tirana do të marrë masa të tjera për të mbajtur sa më larg prindërit që jo vetëm dëmtojnë fëmijët e tyre, por cenojnë integritetin e trajnerëve dhe imazhin e një klubi që gjithmonë ka funksionuar si një familje e madhe. Probleme te ngjashme janë hasur dhe në të shkuarën dhe KF Tirana ka punuar gjithmonë për të mbajtur larg prindërit nga fëmijët dhe problemet",- thuhet në njoftimin zyrtar të klubit të futbollit të Tiranës. Ky nuk është rasti i parë kur një trajner futbolli dhunohet fizikisht. Më herët trajneri i Vllaznisë Ernest Gjoka pas stërvitjes është bërë pre e një sulmi me thikë. Një djali i ri me kapuç në kokë i është afruar nga mbrapa Gjokës dhe ka tentuar që ta therë me një thikë që kishte në dorë. Trajneri e ka nuhatur dhe ka tentuar të largohet. Agresori e ka goditur me grusht, ndërsa trajneri është munduar ta shtyjë me këmbë. Aty ka rastisur kapiteni i Vllaznisë Gilman Lika, i cili i ka ardhur në ndihmë teknikut Gjoka bashkë me disa qytetarë të rastit. Pas ngjarjes së rëndë 48-vjeçari Ernest Gjoka dha një mesazh të qartë se futbollist nuk mund të bëhesh me zor.

**MIGEN MEMELLI**

"Djali, i cili u bë problem, është kapiteni i skuadrës dhe është trajtuar më mirë se kushdo tjetër. Shpresoj që klubi të marrë masat e duhura dhe ai të përjashtohet nga klubi i Tiranës. Nuk mund të mbajmë njerëz të padisiplinuar dhe arrogant. Nuk është hera e parë që një incident i tillë ndodh me këtë person. Më herët e ka përjashtuar trajneri i kombëtares U-17, ka debatuar me trajnerë të tjerë më përpara, dhe tashmë ndodhi incidenti me mua",- tregon Memelli.

## Policia operacion blic në Tiranë, bien në pranga dy persona për armëmbajtje pa leje dhe lëndë narkotike

Policia e Tiranës vijon kontrollet në terren për kapjen e personave në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo që tentojnë të shpërndajnë lëndë narkotike. Në kuadër të këtyre kontrolleve ditën e djeshme janë shoqëruar për verifikim në komisariatet e policisë Tiranë, 22 shtetas, me precedentë penalë të mëparshëm. Ndërkohë gjatë verifikimeve të kryera nga uniformat blu janë kapur dhe arrestuar në flagrancë dy shtetas, të cilët qarkullonin me armë zjarri. Bëhet fjalë për shtetasit Dritan Agën dhe Enver Sylajn. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në zbatim të Planit të masave për rritjen e parametrave të sigurisë, për parandalimin e ngjarjeve kriminale si dhe për evidentimin dhe goditjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri apo tentojnë të shpërndajnë lëndë narkotike, gjatë mbrëmjes dhe orëve të para të mëngjesit të djeshëm, kanë ushtruar kontrolle me pika të lëvizshme, në të gjitha rrugët e Tiranës. Si rezultat i kontrolleve, në territorin që mbulon Komisariati i Policisë nr. 1, rreth orës 22:30, në rrugën "Petro Nini Luarasi", gjatë kontrollit fizik të ushtruar nga Policia shtetasit Dritan Aga, 37 vjeç, banues në Tiranë, iu gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë, një krehër me 10 fishekë, 4 doza me lëndë të dyshuar narkotike e llojit "Cannabis Sativa". Shtetasi Dritan Aga u arrestua në flagrancë për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", si dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 278 dhe 283 i Kodit Penal. Gjithashtu, në rrugën "Dritan Hoxha", tek sheshi "Karl Topia", në territorin që mbulon Komisariati nr. 2, gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin tip "Seat", që drejtohej nga shtetasi Enver Sylaj, 27 vjeç, banues në Tropojë, u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me dy krehra me 14 fishekë.

Shtetasi Enver Sylaj u arrestua në flagrancë për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit".




**ARRESTIMI**

Në kuadër të kontrolleve policore ditën e djeshme janë shoqëruar për verifikim në komisariatet e Tiranës, 22 shtetas, me precedentë penalë të mëparshëm. Ndërkohë gjatë verifikimeve të kryera nga uniformat blu janë kapur dhe arrestuar në flagrancë dy shtetas, të cilët qarkullonin me armë zjarri. Bëhet fjalë për shtetasit Dritan Agën dhe Enver Sylajn.

### Dëshmia e Iljaz Labit: I dërgova drejtorit në zyrë shumën prej 20 mijë eurosh

# Procesi ndaj Artur Zotos, ekspertët dorëzojnë 728 imazhe nga kamerat e sigurisë

## Në 140 orë filmime zbardhen hyrje-daljet në zyrën e ish-kreut të burgjeve

Ina Allkanjari

Ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto, i cili akuzohet për "korrupsion pasiv" gjatë një procedure tenderimi të ushqimit në burgje vazhdon përballjen me gjykatën për Krimet e Rënda. Në procesin gjyqësor ndaj tij, u administruan si prova të reja, 728 foto të shkëputura nga 140 orë pamje filmike të një kamere sigurie në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Më herët ish-zëvendësi i tij, Iljas Labi, ka dëshmuar në prokurori se i ka dërgua Zotos në zyrë shumën prej 20 mijë eurosh, si ryshfet për tenderin e ushqimeve. Labi theksoi se biznesmeni Shemsi Sinani ia ka dhënë shumën e parave tek një lokal tek Blloku, me qëllim që t'ia jepte ish-drejtorit. Tashmë Labi mban statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Këtë dëshmi ish-drejtori i burgjeve e ka mohuar duke theksuar se nuk është i përfshirë në këtë aferë korruptive. Zoto më herët është shprehur se nuk ka bërë asnjë faj dhe se marrëdhëniet me Labin ishin të ngrira. "Nuk kam asnjë faj. Me Iliaz Labin kam pasur komunikim të ngrirë. Ai nuk ka qenë asnjëherë në zyrën time. Madje nuk kam pasur asnjë komunikim dhe as takim me biznesmenët. Nëse jam këtu për gjëra të tjera, e dini ju. Gjykata të ngrejë një komision të veçantë që të verifikojë tenderin për të cilin akuzohem", tha Zoto. Gjithashtu, ish-drejtori kërkoi të ekspertoheshin pamjet filmike të kamerave të sigurisë së institucionit, prej nga vërtetohet se Iljas Labi nuk hynte kurrë në zyrën e tij. Akt-ekspertimi u përpilua nga dy ekspertë të Policisë Shkencore, të cilët i thanë gjykatës se kanë vëzhguar 140 orë pamje filmike, në të cilat nuk shquhet qartë dera e zyrës së ish-nëndrejtorit Iliaz Labi. Megjithatë ekspertët kanë shkëputur me foto të gjithë personat që kanë hyrë dhe dalë nga zyra e ish-drejtorit Zoto.


Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Artur Zoto

Gjykata nuk dha detaje se cilët janë personat që shfaqen në këtë foto dhe nëse e rëndojnë ose jo pozitën e të pandehurit, por vendosi t'i administronte si provë. Gjykata vendosi t'i drejtohet me shkrese zyrtare Drejtorisë së Burgjeve për të pyetur nëse në datat 23-24 maj 2016 i pandehuri dhe ish-zëvendësi i tij Labi janë paraqitur ose jo në punë dhe nëse kanë zhvilluar ndonjë aktivitet jashtë institucionit. Pasi të mbërrijë edhe kjo përgjigje, prokuroria do të lexojë pretencën ndaj të pandehurit Artur Zoto.

**AKUZA**

Ish-drejtori i burgjeve, Artur Zoto dyshohet se është i përfshirë në korrupsionin me tenderët e ushqimeve, për të cilat u arrestua edhe zv/drejtori i burgjeve Iljaz Labi. Një seri bisedash të përgjuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, kanë ngritur dyshime të forta për implikimin të Zotos në aferat korruptive në tenderët e ushqimit në burgje. Në dosjen hetimore, ndodhen dhjetëra procesverbale me biseda të transkiptuara, të cilat tregojnë se drejtori Zoto, tashmë i dorëhequr ka qenë në dijeni të këtyre aferave korruptive, dhe se Iljaz Labi nuk bënte asnjë hap, pa miratimin e tij. Dy ditë pas operacionit të arrestimit të zv/ndësit të tij Iljaz Labi dhe katër biznesmenëve Elidjan Laskaj, Ylber Kalaja, Shemsi Sinani e Nexhmi Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka dhënë dorëheqjen, duke ja justifikuar largimin ministrit të Drejtësisë, Manjani nëpërmjet një letre, ku i shkruante se ishin motivet personale dhe familjare të tij, që e çonin në largimin nga kjo detyrë.

**AKT-EKSPERTIMI**

Ish-drejtori kërkoi të ekspertoheshin pamjet filmike të kamerave të sigurisë së institucionit, prej nga vërtetohet se Iljas Labi nuk hynte kurrë në zyrën e tij. Akt-ekspertimi u përpilua nga dy ekspertë të Policisë Shkencore, të cilët i thanë gjykatës se kanë vëzhguar 140 orë pamje filmike, në të cilat nuk shquhet qartë dera e zyrës së ish-nëndrejtorit Iliaz Labi.

### Nën akuzë për mashtrim dhe trafik droge, ekstradohen nga Gjermania dhe Greqia dy shqiptarë

**TIRANE** - Një shqiptar nga Greqia dhe një tjetër nga Gjermania janë ekstraduar ditën e djeshme për në Shqipëri pasi janë dënuar për "Mashtrim" dhe "Trafikim të lëndëve narkotike". Nga Interpol Tirana u krye ekstradimi nga Frankfurti/Gjermani drejt vendit tonë i shtetasit Shefki Lusha, 49 vjeç, lindur në Dibër. Shefki Lusha ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dënuar këtë shtetas me 5 vjet burg për veprën penale të "Mashtrimit". Sipas policisë, Shefki Lusha ka mashtruar shtetasit D.R, Q.B., A.R, dhe S.E., duke u marrë shuma të konsiderueshme parash, me premtimin se do t'ua kthente, por pasi u ka marrë lekët këtyre shtetasve është larguar jashtë vendit. Gjithashtu, po nga Interpol Tirana u krye ekstradimi nga Athina/Greqi drejt vendit tonë, i shtetasit Vasil Dervishanji, 45 vjeç, lindur në Berat dhe banues në Greqi.

### Në verifikim llogaritë bankare të të pandehurve e familjarëve të tyre

# Trafikuan shqiptarë në SHBA, Kanada dhe Britani, nis hetimi pasuror për 39 të arrestuarit

Në kuadër të hetimeve ndaj personave të arrestuar për trafikimin e 1 mijë shqiptarëve drejt Anglisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prokuroria nis hetimin pasuror për ta. Organi i akuzës ka vendosur të verifikojë pasuritë e 39 të prangosurve. Kjo pas dyshimeve se grupi ka përfituar një shumë prej 15 milionë dollarësh nga aktiviteti kriminal. Grupi hetimor do të shqyrtojë nëse të pandehurit arrijnë t'i justifikojnë të ardhurat dhe burimin e tyre. Fillimisht mësohet se u është dërguar një shkresë të gjitha bankave të nivelit të dytë, për të identifikuar të gjithë llogaritë bankare të të arrestuarve dhe familjarëve të tyre të afërt. Organizata kriminale, e cila dërgonte shtetas shqiptare drejt tri destinacioneve kryesore u godit pas një hetimi disa mujor nga Prokuroria për Krime të Rënda. Kundrejt pagesave, të cilat varionin nga 7 mijë paund deri në 25-30 mijë dollarë, grupet kriminale, pajisnin qytetarët me pasaporta të falsifikuara të vendeve të BE-së e në këtë mënyrë, ata udhëtonin drejt destinacioneve në katër rrugë kryesore. Rruga kryesore e kalimit të qytetarëve, ishte nga Shqipëria në Itali-Francë-Meksikë e më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rruga e dytë që ndiqej ishte ajo nga vendi ynë në Malin e Zi, më pas në Serbi e Gjermani. Prej andej qytetarët udhëtonin drejt Spanjës. Nga këtu përshkonin dy rrugë. Kishte prej tyre që kalonin në Meksikë me destinacion final SHBA, ndërsa të tjerë kalonin përmes Kosta Rikës. Një rrugë tjetër e ndjekur nga trafikantët, ishte ajo e kalimit përmes Kosovës, prej andej qytetarët udhëtonin drejt Bullgarisë ose Belgjikës. Nga kjo e fundit kalonin në Republikën Domenikane e prej andej në Kanada. Ata që kalonin nga Bullgaria, udhëtonin drejt Spanjës dhe përmes Kosta Rikës hynin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Policia shqiptare bën me dije se për shkatërrimin e kësaj linje rol vendimtar kanë luajtur edhe 2 agjentët speciale të Shërbimit Diplomatik të Sigurisë së Departamentit Amerikan të Shtetit, të atashuar pranë ambasadës së SHBA-ve në Tiranë. Gjatë operacionit policor u goditën shtatë grupe të strukturuara kriminale, u lëshuan 51-urdhër arreste, por vetëm 39 u ekzekutuan, ndërsa 12 persona të tjerë janë shpallur në kërkim. Ndërkohë dy ditë pas finalizimit të këtij megaoperacioni u zbulua e shkuara kriminale e disa prej personave të arrestuar, të cilët mendohet të jenë drejtues në këto organizata kriminale. Gjithashtu, u mësua se disa prej të arrestuarve janë aksionerë dhe disponojnë biznese të ndryshme në Shqipëri.



Foto ilustruese

**HETIMI**

Pas dyshimeve se grupi kriminal ka përfituar një shumë prej 15 milionë dollarësh nga aktiviteti i jashtëligjshëm, grupi hetimor do të shqyrtojë nëse ata arrijnë t'i justifikojnë të ardhurat dhe burimin e tyre. Fillimisht mësohet se u është dërguar një shkresë të gjitha bankave të nivelit të dytë, për të identifikuar të gjithë llogaritë bankare të të arrestuarve dhe familjarëve të tyre të afërt.

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**

" "Pemtore+Truall+Ndertese me sip totale 620m2, nga e cila 200 m2eshte truall dhe 90 m2 eshte ndertese , me Numer pasurie 430/17, e ndodhur ne Zonen Kadasrale 1100, e rregjistruar ne rregjistrin hipotekore volumi 6, faqe 227,me adrese ne Fshatin Barbullush Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e siperpershkruar , eshte në vleren 1,568,000 ( njemilione e peseqind e gjashtedhjeteetete mije ) Lekë .

Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date **26.03.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

**NJOFTIM**

Studio Përmbarimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e II(Dytë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.2/32+1-8/1, vol 6, faqe 183, Z.K.8514, e apartament, me sipërfaqe totale 70,13m2, e ndodhur në Durres, çmimi 27.490,4 Euro.

Ankandi zhvillohet ne date **26.03.2018** në ambientet e Studios Përmbarimore Zyber SHEHU me **adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë,**
**Cel.0682089339, osë adresën e-mail:shehuzyber@yahoo.com**






Droga e sekuestruar në Turqi



## Droga me vlerë 5 milionë euro, prangosen edhe 10 persona të tjerë

# Sekuestrohet 1.1 tonë kanabis në Turqi, arrestohet baroni shqiptar, Met Kanani

## *Mediat turke: Ka lidhje me politikanë shqiptarë*



I arrestuari, Met Kanani

**TURQI**

Sekuestrimi i një sasie prej 1.1 tonë kanabis dhe arrestimi në Turqi i shqiptarit Met Kanani, i njohur me pseudonimin "Met shqiptari" ka bërë bujë në mediat vendëse. Ai nuk është një emër i panjohur për autoritetet turke, ato greke, por edhe shqiptare. Ndaj mediat turke kanë nxituar ta etiketojnë edhe si "Eskobari shqiptar", ndërsa shkruajnë edhe për lidhjet e tij me politikanë shqiptarë. Nuk përmendin emra, por shkruajnë se Met Kanani ka lidhje të forta me politikanë të fuqishëm shqiptarë. Po ashtu, flasin edhe për një operacion të policisë greke nëntorin e kaluar, në Egje. Gomonia e tij u bllokua me 1.3 tonë kanabis, por Kanani nuk la asnjë gjurmë. Për këtë rast, sipas mediave turke u njoftua dhe Policia Kufitare e Shqipërisë dhe autoritetet turke. Kanani raportohet se kishte në duart e tij një pjesë të rëndësishme të rrugës ballkanike të trafikimit të drogës. Sipas ekspertëve, nëpërmjet kësaj rruge, banda e tij dërgonte në Europë heroinën që vjen nga Afganistani, Irani dhe Turqia, teksa nga Europa merrte kanabis dhe pilula droge, të cilat i trafikonte kryesisht për në vendet arabe.

**OPERACIONI**

Prej më shumë se 6 muajsh autoritetet turke kanë zhvilluar hetime për Met Kananin. Ekipet e Drejtorisë së Antitrafikut në Stamboll kishin pikasur disa njerëz të Met Kananit në Turqi dhe kishin nisur ndjekjen e tyre. Mediat turke që citojnë materiale nga hetimet, shkruajnë se grupi përdorte brigjet e Bodrumit për trafikimin e drogës. Gjatë hetimit u zbulua se në Turqi do të mbërrinte edhe vetë "Eskobari shqiptar" i drogës, Met Kanani. Me mbërritjen e Kananit në Bodrum, policia nisi ndjekjen e tij nga afër. Gjatë hetimeve u pa se ai po shikonte mbërritjen e drogës me një jaht në brigjet e Mulas, nga maja e një kodre. Por "Eskobari shqiptar" nuk e dinte se po ndiqej nga policia, e cila edhe e kishte fotografuar. Banda e tij përdorte si depo një adresë në Mulas, e cila përdorej edhe për magazinimin e ujit. Më të provuar vendmagazinimin e drogës, policia vendosi të niste operacionin për arrestimin e trafikantëve. Policia bastisi depon në orën 02:30 të mëngjesit të së martës. Në depo u arrestua "Met shqiptari" dhe 6 njerëz të tij, si dhe u sekuestruan 1.1 tonë kanabis me vlerë mbi 5 milionë euro. Ndërsa në valën e dytë të operacionit të zhvilluar të enjten me pjesëmarrjen 250 policëve u arrestuan edhe 4 të tjerë.

**HETIMI**

Prej më shumë se 6 muajsh autoritetet turke kanë zhvilluar hetime për Met Kananin. Me mbërritjen e Kananit në Bodrum, policia nisi ndjekjen e tij nga afër. Gjatë hetimeve u pa se ai po shikonte mbërritjen e drogës me një jaht në brigjet e Mulas, nga maja e një kodre. Por "Eskobari shqiptar" nuk e dinte se po ndiqej nga policia, e cila edhe e kishte fotografuar. Banda e tij përdorte si depo një adresë në Mulas, e cila përdorej edhe për magazinimin e ujit.

HAP
Health for all project

VACANCY ANNOUNCEMENT

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (SwissTPH), and the NGOs Terre des hommes (Tdh) and Save the Children (SC), though HAP Center. The Project started in January 2015 and will have an implementation timeframe of 4 years. Its overall goal is that the Albanian population, particularly the most vulnerable, benefit from better health due to improved Primary Health Care (PHC) services and health promotion activities.

Save the Children is recruiting for motivated and experienced staff for the project "HAP project"

Post title: **Procurement Assistant for HAP project Albania Country Office**
Application dateline: **3rd April 2018**, 1:00pm

The Procurement Assistant for HAP maintain effective procurement and logistic system, supporting the project to deliver objectives effectively and efficiently.

**REQUIRED QUALIFICATIONS AND EXPERIENCES**

- Bachelor degree on Management, Administration or relevant equivalent qualification with relevant experience in the field of procurement/logistic.
- Communication skills both written and verbal in order to establish effective relationships with a wide variety of internal and external audiences.
- Good understanding of the Albanian market.
- 5 years of experience in implementing procurement for different public and/or private organizations and/or technical cooperation projects. Extensive knowledge of procurement procedures and guidelines would be an asset.
- Previous experience in a logistic/administrative role.
- Strong attention to detail and organizational skills.
- Ability to work in a challenging environment.
- Solution focused with the ability to work under pressure, quickly and flexibly.
- Empathy with the values and objectives of SC and the Swiss Agency for Development and Cooperation.
- Good written and spoken Albanian and English language skill.
- Computer literal and internet applications.

Information regarding the duties and responsibilities (Job Description) you may find on the website of Save the Children https://albania.savethechildren.net/jobs

Interested candidates should submit the following within the application dateline:

1- Cover letter clearly explaining your motivation for applying your motivation for applying for the position and how you meet the position criteria;
2- Detailed CV
3- List of reference with contact details

Application should be sent by email with subject **"Procurement Assistant – HAP project"** to the address below.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Swiss TPH
Terre des hommes
Save the Children

## Drejtonin trafikun e kokainës në veri të Italisë

# Operacioni "Shqiponja e zezë", prangosen 16 shqiptarë



**ITALI** - Policia italiane ka arrestuar 16 shqiptarë gjatë operacionit "Shqiponja e zezë", ndërsa janë sekuestruar 440 kg marijuanë dhe 10 kg heroinë në kohë të ndryshme. Hetimi i udhëhequr nga prokurori i Komos, Nicola Piacente dhe zëvendësprokurori Antonio Nalesso, bëri të mundur sekuestrimin edhe të 200 kg substancë heroine që përdorej për përzierje. "Il giorno" shkruan se grupi kriminal e kishte shtrirë aktivitetin e tij në krahinat e Komos, Milano, Genoa dhe Luça. Sipas prokurorit Nicola Piacente, "koka" e këtij grupi fshihet në Spanjë. Përveç futjes së drogës në Zvicër, grupi kriminal i ka tentakulat edhe në Holandë, Spanjë dhe Shqipëri. Shqiptari dhe grupi që ai drejtonte, sipas policisë ka futur në territorin italian sasi të konsiderueshme kokaine nga Spanja dhe Holanda, ndërsa, kanabisi vinte nga Shqipëria. Pasi furnizohej tregu vendës, një sasi e drogës futej edhe në Zvicër. Gjithashtu, hetuesit italianë thonë se kanë identifikuar edhe një shqiptar tjetër, shofer kamioni që është përgjegjës për futjen e 200 kg kokainë nga Spanja dhe Holanda. Po ashtu grupi ka futur edhe përzier kokainë në shampo.

## STUDIMET NË ITALI
### PROCEDURA

Drejtuesja e Inas Albania: 24 korriku, afati përfundimtar për fazën e para regjistrimit

# Hapet faza e parë për studime në Itali, ja si të aplikoni

## *Beskida Aliaj: Degët e larmishme ku mund të kandidoni*



Voltiza Duro

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një nga programet e studimit në ciklin e parë apo të dytë në universitetet italiane, tashmë mund të informohen në lidhje me procedurën. Ditën e djeshme, Ambasada Italiane ka çelur zyrtarisht fazën e parë të studimeve, që konsiston në paraqitjen e kërkesës për pararegjistrim nga ana e aplikantëve para datës 24 korrik të këtij viti. Në një intervistë për Gazeta Shqiptare, drejtuesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj sqaron se në kërkesë duhet të shënohet qartësisht vetëm një degë universitare e më tej prezanton të gjithë dokumentacionin që duhet dorëzuar pranë ambasadës italiane të Tiranës apo konsullatës italiane në Vlorë. Aliaj shton se dokumentet e shkollës së mesme duhet të vulosen pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe pranë Ministrisë së Arsimit e më pas të apostilohen pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përkthehen në gjuhën italiane nga njëri prej përkthyesve. Drejtuesja e INAS Albania bën me dije për të interesuarit se mbrojtja e certifikuar e gjuhës italiane është e domosdoshme, e më tej tregon se studentët kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një nga universitetet italiane. Fazën e parë, studentët paraqesin dokumentacionin e kërkuar e më tej ky informacion merret në shqyrtim deri në kthimin e një përgjigjeje përfundimtare mbi aprovimin ose jo të kërkesës.

**Cilat janë hapat që duhet të ndjekin shqiptarët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta për vitin akademik 2018-2019 në një prej universiteteve italiane? Çfarë përfshin faza e parë e aplikimit?**

Faza e parë që do i nënshtrohen të interesuarit është paraqitja e kërkesës për para-regjistrimin. Brenda datës 24 korrik 2018 studentët që dëshirojnë të fillojnë procedurën e pararegjistrimit, duhet të shkarkojnë dhe të plotësojnë dokumentin Excel, pastaj ta ruajnë me emrin: Preiscrizione Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit) dhe ta dërgojnë te bashkëlidhur në e-mailin: scuole. tirana @ esteri. it, me objekt: Preiscrizione 2018 Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit). Më tej studentët duhet të caktojnë në kohë një takim pranë ambasadës italiane përmes faqes në internetit: https://prenotaonline. esteri.it.



Drejtuesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj

**Studentët mund ta bëjnë kërkesën për disa programe studimi apo vetëm për një të tillë?**

Dua të bëj me dije për të gjithë studentët e interesuar mbi faktin se në kërkesë duhet të shënohet qartësisht vetëm një degë universitare. Ndërkaq, studentët që nuk zotërojnë më dëftesën origjinale do të dorëzojnë një vërtetim me rezultatet e të gjithë viteve bashkë me ato të Maturës Shtetërore dhe fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para-mbrapa. Theksoj dhe faktin se të gjithë studentët e mitur duhet të jenë të shoqëruar nga të dy prindërit (ose nga njëri prej prindërve i pajisur me autorizimin e prindit tjetër) në momentin e paraqitjes së kërkesës së pararegjistrimit bashkë me një certifikatë familjare (modeli shumëgjuhësh) të apostiluar.

**Cilat janë disa prej degëve ku mund të aplikojnë kandidatët?**

Studentët e interesuar kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një prej universiteteve italiane dhe mund t'i shohin këto programe te linku përkatës. Për mënyrat, skadencat e procedurës së pararegjistrimit dhe zgjedhjes së degës, duhet të konsultoni edhe faqen e internetit: www.studiare-in-italia.it/. Studentët që dëshirojnë të regjistrohen "NË DEGËT ME NUMËR TË MBYLLUR" (janë programet që duhet t'i nënshtrohen një provimi pranimi me detyrim) duhet të regjistrohen për të dhënë provimin e pranimit edhe në faqen www.univeritaly.it. Kjo vlen për degët Mjekësi e Kirurgji, Mjekësi dhe Kirurgji në anglisht për universitetet që e parashikojnë, Dentist dhe Proteza Dentare, Veterinari, Arkitekturë, Profesione Shëndetësore si dhe Shkencat e Edukimit Fillor.

**Në cilat nivele studimi mund të bëhet kërkesa nga ana e studentëve?**

Kurset e ciklit të parë apo ndryshe Bachelor zakonisht zgjasin tre vjet, ndërsa kurset e masterit kategorizohen në diplomë Master prej dy vjetësh pas Bachelorit; si dhe diplomë Masteri me një cikël të vetëm me kohëzgjatje pesëvjeçare ose gjashtëvjeçare si dega Mjekësi e kirurgji, stomatologji, mjekësi veterinare, arkitekturë me një cikël apo Juridik.

> "Studentët që dëshirojnë të regjistrohen në kurset e ciklit të dytë (Laurea Magistrale), jo me numër të mbyllur, përveç Diplomës së Maturës Shtetërore si më lart, duhet të dorëzojnë edhe Diplomën universitare me listën e notave të apostiluara dhe të përkthyera në italisht"



**Çfarë përfshihet në dokumentacionin që duhet të dorëzojnë studentët?**

Dokumentet duhet të paraqiten në zarf të tejdukshëm ku studentët duhet të kenë përshirë pasaportën dhe një fotokopje të saj me vlefshmëri të paktën 90 ditë nga vlefshmëria e vizës; certifikatën e lindjes (modeli shumëgju-

➔

### DOKUMENTACIONI

Dokumentet që duhet të paraqiten në zarf të tejdukshëm janë:

1. Pasaportë dhe fotokopje të saj me vlefshmëri të paktën 90 ditë nga vlefshmëria e vizës;
2. Certifikatë lindjeje (modeli shumëgjuhësh) e apostiluar;
3. Formulari i regjistrimit (Mod.A), në tre kopje tërësisht i plotësuar por i pa firmosur. Tërhiqet vëmendja e studentëve mbi faktin se në kërkesë duhet të shënohet qartësisht vetëm një degë universitare;
4. Formulari i autentikimit të fotografisë, në tre kopje tërësisht i plotësuar por i pa firmosur;
5. Katër (4) fotografi me ngjyra për dokument;
6. Diploma e Maturës Shtetërore dhe Certifikata e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje e noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para mbrapa. Studentët që nuk zotërojnë më Dëftesën origjinale do të dorëzojnë një Vërtetim me rezultatet e të gjithë viteve bashkë me ato të Maturës Shtetërore dhe fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para-mbrapa.

* *Nxënësit e regjistruar në vitin e fundit ë shkollës së mesme, që do të marrin Dëftesën në verën e 2018-ës, do të paraqesin një fotokopje të thjeshtë të "Formularit A1" me të cilin janë regjistruar online për provimet e maturës 2018.*

* *Studentët që janë regjistruar këtë vit për të dhënë provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore duhet të dorëzojnë fotokopje të thjeshtë të "Formularit A1Z". Pas marrjes së provimeve, këta studentë duhet të dorëzojnë në Ambasadë Diplomën e Maturës ose Vërtetim dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje të noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para-mbrapa.*



“

Studentët e interesuar kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një prej universiteteve italiane. "DEGËT ME NUMËR TË MBYLLUR" janë programet që duhet t'i nënshtrohen një provimi pranimi me detyrim

## PROGRAMET E STUDIMIT

- Studentët e interesuar kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një prej universiteteve italiane
- Studentët që dëshirojnë të regjistrohen "NË DEGËT ME NUMËR TË MBYLLUR" (janë programet që duhet t'i nënshtrohen një provimi pranimi me detyrim) duhet të regjistrohen për të dhënë provimin e pranimit edhe në faqen www.univeritaly.it.
- Kjo vlen për degët Mjekësi e Kirurgji, Mjekësi dhe Kirurgji në anglisht për universitetet që e parashikojnë, Dentist dhe Proteza Dentare, Veterinari, Arkitekturë, Profesione Shëndetësore si dhe Shkencat e Edukimit Fillor.

Paraqitja e kërkesës për para regjistrim

Brenda datës 24/07/2018 studentët që dëshirojnë të fillojnë procedurën e para-regjistrimit, duhet:

1. Të shkarkojnë dhe të plotësojnë Dokumentin Excel, pastaj ta ruajnë me emrin: Preiscrizione Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit) dhe ta dërgojnë te bashkëlidhur në e-mailin: scuole.tirana@esteri.it, me objekt: Preiscrizione 2018 Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit);
2. Të caktojnë në kohë një takim pranë ambasadës italiane.

← hësh) e apostiluar; si dhe një formular regjistrimi (Mod.A), në tre kopje tërësisht i plotësuar por i pa firmosur. Gjithashtu studentët duhet të paraqesin edhe një formular të autentikimit të fotografisë, në tri kopje tërësisht i plotësuar, por i pa firmosur; si dhe 4 fotografi me ngjyra për dokument. Të interesuarit normalisht që duhet të dorëzojnë edhe diplomën e Maturës Shtetërore dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje e noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para mbrapa.

**Po maturantët që do të marrin dëftesën verën e 2018-ës, si duhet të veprojnë?**

Nxënësit e regjistruar në vitin e fundit ë shkollës së mesme, që do të marrin Dëftesën në verën e 2018-ës, do të paraqesin një fotokopje të thjeshtë të "Formularit A1" me të cilin janë regjistruar online për provimet e maturës 2018. Pas marrjes së provimeve këta studentë duhet të dorëzojnë në ambasadë Diplomën e Maturës dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje të noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para mbrapa. Ndërsa, studentët që janë regjistruar këtë vit për të dhënë provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore duhet të dorëzojnë fotokopje të thjeshtë të "Formularit A1Z". Pas marrjes së provimeve, këta studentë duhet të dorëzojnë në ambasadë Diplomën e Maturës ose vërtetim dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje të noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqeve para-mbrapa.

**Cila është procedura që duhet ndjekur për studentët që aplikojnë në master?**

Studentët që dëshirojnë të regjistrohen në kurset e ciklit të dytë (Laurea Magistrale), jo me numër të mbyllur, si specializim ose kurs të shkurtuar, përveç Diplomës së Maturës Shtetërore si më lart, duhet të dorëzojnë edhe Diplomën universitare me listën e notave të apostiluara dhe të përkthyera në italisht bashkë me fotokopje të thjeshta të të gjitha faqeve para mbrapa, si dhe programin e detajuar të studimeve, të apostiluar dhe të përthyer në italisht bashkë me fotokopje të faqes së parë dhe apostiles. Studentët e regjistruar në vit të fundit të sistemit trevjeçar, që do të marrin Diplomën brenda verës së vitit 2018, duhet të dorëzojnë një vërtetim, që provon regjistrimin në vit të tretë dhe provimet e dhëna. Diploma përfundimtare (Vërtetimi), lista e notave dhe programi i detajuar i studimeve do të dorëzohet në Ambasadë sipas mënyrës së lartpërmendur.

**Para se të dorëzohet dokumentacioni, a është e nevojshme të vuloset pranë MASR?**

Dokumentet e shkollës së mesme duhet të vulosen pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe pranë Ministrisë së Arsimit. Më pas, dokumentet duhet të apostilohen pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përkthehen në gjuhën italiane nga njëri prej përkthyesve të betuar, lista me emrat e të cilëve është e publikuar në faqen e internetit të ambasadës. Dokumentet universitare duhet të vulosen pranë Rektoratit, të apostilohen pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përkthehen në gjuhën italiane nga njëri prej përkthyesve të betuar, lista me emrat e të cilëve është e publikuar në faqen e internetit të ambasadës. Dokumentet e shkollës/universitetit duhet të shoqërohen nga fotokopjet e thjeshta të të gjitha faqeve para-mbrapa, me përjashtim të programit të detajuar të studimeve të cilit i fotokopjohet vetëm faqja e parë dhe vula apostile.

**Në rastet kur të dhënat në dokumentacion nuk janë të plota, si duhet të procedohet nga ana e studentit?**

Nëse Diplomat universitare apo lista e notave nuk kanë të dhënat personale të plota (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje), dhe numër regjistri ose diplome, duhet të paraqitet edhe një vërtetim lëshuar nga Universiteti i cili i përmban ato, si dhe të dhënat e degës së studimit.

**A është e domosdoshme certifikata e mbrojtjes së gjuhës italiane?**

Sigurisht që po! Aplikantët duhet të paraqesin një certifikatë të gjuhës italiane: fotokopje e certifikatës së gjuhës italiane të lëshuar nga Universiteti për të Huajt i Perugia-s (CELI), Universiteti për të Huajt i Siena-s (CILS), Universiteti Roma 3, ose Shoqata Dante Alighieri ose nga Instituti Italian i Kulturës. Studentët që do të kryejnë provimin në sesionin e afërm për njohjen e gjuhës, mund të paraqesin regjistrimin në provim. Për studentët që kërkojnë të regjistrohen në degët me numër të mbyllur, njohja e gjuhës italiane quhet e mirëqenë nëse kalojnë me sukses provimin e pranimit në universitet. Ndërkohë, studentët që duan të regjistrohen në degët që zhvillohen në gjuhë huaj (anglisht), është e nevojshme të paraqesin një certifikatë njohjes së asaj gjuhe. Për informacione të mëtejshme mbi procedurën e pararegjistrimit ftojmë studentët të konsultojnë rregullisht faqen e internetit www.ambtirana.esteri.it, por dhe ti drejtoheni patronatatit INAS CLS Albania për sqarime të detajuara.

**Ku mund të dorëzohet dokumentacioni nga ana e studentëve?**

Të gjithë dokumentet e përgatitur nga studenti, mund të dorëzohen në ambasadën italiane të Tiranës, pra për ata me vendbanim në qytetet e mëposhtme: Malësi e Madhe, Shkodër, Lezhë, Tropojë, Pukë, Mirditë, Has, Kukës, Dibër, Tiranë, Durrës, Kavajë, Peqin, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Bulqizë, Mat, Krujë, Kurbin, Pogradec, Korçë, Devoll dhe Kolonjë duhet t'i paraqesin dokumentet në institucionin e sipërpërmendur. Ndërsa të gjitha rrethet e Shqipërisë jugore duhet t'i drejtohen konsullatës italiane në Vlorë për dorëzimin e dokumentacionit.

**Cilat janë rekomandimet tuaja për studentët e interesuar?**

Fillimisht duhet të lexoni me kujdes rregulloren (Band) që afishohet në faqen zyrtare të çdo universiteti italian ku do të shënohen udhëzime të detajuara në lidhje me datat e provimeve, bursat ekonomike, si dhe afatet e skadencës së regjistrimit.

**Cila është ndihma që i ofrohet aplikantëve nga Patronati INAS Albania?**

Patronati INAS ALBANIA, jep të gjithë konsulencën e nevojshme, që nga fillimi i procedurave dhe deri në mbylljen e tyre për të gjithë studentët që paraqiten pranë zyrave tona. Të gjitha shërbimet tona janë FALAS, pa asnjë lloj pagese. Edhe mbas fitimit të së drejtës për studime në Itali, INAS CISL ALBANIA, ndihmon studentët shqiptarë, nëpërmjet strukturave që ka në të gjithë Italinë, deri në akomodimin e plotë të tyre si edhe në plotësimin e dokumenteve për leje qëndrimin italian nga zyrat e Patronato Inas Cisl që ndodhen të shpërndara në të gjithë Italinë.

“ KUSHTI

Aplikantët duhet të paraqesin një certifikatë të gjuhës italiane: fotokopje e certifikatës së gjuhës italiane të lëshuar nga Universiteti për të Huajt i Perugia-s (CELI), Universiteti për të Huajt i Siena-s (CILS), Universiteti Roma 3, ose Shoqata Dante Alighieri ose nga Instituti Italian i Kulturës.

## NISMA



# Kryeqytetit i shtohen mbi 108 mijë pemë të reja

Numri i pemëve të mbjella në kryeqytet ka arritur në 108.328, kjo falë angazhimit të shumë qytetarëve, institucioneve, qindra bizneseve e donatorëve që iu bashkuan këtij aksioni. Por, nisur nga kërkesa e madhe e qytetarëve dhe subjektet e tjera private që janë regjistruar në radhën për të mbjellë pemë, kjo nismë do të shtyhet deri në 22 prill, Ditën e Tokës. I pranishëm në mbjelljen e pemëve të reja në liqenin e Farkës, kryebashkiaku Erion Veliaj deklaroi se për shkak të interesit të lartë dhe numrit të qytetarëve dhe të kompanive që janë regjistruar në listë pritje për të dhuruar pemë, aksioni për mbjelljen do të vijojë dhe për një muaj tjetër.

## AKSIONI

# AKU bllokon subjektin, tregtonte mish të pakontrolluar

AKU, gjatë aksionit të zhvilluar në Gjirokastër ditën e djeshme, konstatoi një ambient në pronësi të xhamisë së Komunitetit Mysliman ku ushtrohej aktivitet i paligjshëm i tregtimit të mishit. Ky subjekt ishte i paregjistruar në QKB dhe tregtonte mish të pasigurt, pa certifikatë dhe dokumente të tjera shoqëruese. Trupa inspektuese e Drejtorisë Rajonale të AKU-së Gjirokastër vendosi masën urgjente për ndërprerje të menjëhershme të aktivitetit si dhe masën administrative gjobë prej 200 mijë lekësh. Po ashtu, u sekuestruan 43 kg mish gjedhi si dhe u bllokuan mjetet e punës, të cilat kalojnë për ruajtje në rezervat materiale të shtetit.

### Përmbytjet, KESH i akordon Ministrisë së Mbrojtjes 10 milionë lekë

# Përkeqësohet situata në Shkodër, 300 shtëpi e 5 mijë ha tokë nën ujë

## *Lokalët: 69 persona janë akomoduar në konvikt*





Përmbytjet në Shkodër

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Shkodra vijon të jetë nën pushtetin e ujit. Burime zyrtare nga Shtabi i Emergjencave Civile dje bënë me dije se stuhia e shirave ka përkeqësuar situatën në këtë qark. Mësohet se sipërfaqja e përmbytur ka arritur në 4958 ha tokë, ndërsa mbi 300 shtëpi janë të rrethuara nga uji. Ndërkohë që mbetet problem mungesa e energjisë elektrike në disa zona. Shtyllat e energjisë elektrike janë dëmtuar dhe kërkohet ndërhyrja e OSHEE-së. Uji nuk ka kursyer as shkollat, disa prej të cilave kanë prezencë uji. Sipas burimeve të mësipërme, 69 persona janë akomoduar në konvikt. Ndërkaq, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare i ka akorduar Ministrisë së Mbrojtjes 10 milionë lekë të reja për përballimin e situatës së krijuar nga përmbytjet në Shkodër. Në njoftimin e KESH thuhet se ky institucion solidarizohet me operacionet e gjithanshme të strukturave shtetërore që po menaxhojnë vështirësitë e krijuara në zonën veriore të vendit nga reshjet e dendura dhe të tejzgjatura të muajit mars 2018. "Organet drejtuese të Korporatës i kanë akorduar Ministrisë së Mbrojtjes një fond prej 10 milionë lekë të reja si kontribut për përballimin e nevojave jetësore të familjeve të shpërngulura. Korporata, ndërkohë që vijon të ndjekë në dinamikë ecurinë e parametrave hidroenergjetikë në kaskadë dhe të operojë veprat energjetike brenda përgjegjësisë së saj ligjore dhe përcaktimeve rregullatore, po bashkërendon informacionin në kohë reale me të gjitha strukturat e pushtetit qendror dhe lokal dhe emergjencat civile",-thuhet në njoftimin e KESH.

**SITUATA**

Pas inspektimeve në terren të bëra nga Bashkia Shkodër rezulton se në njësinë administrative Dajç janë përmbytur 1750 ha tokë, ndërsa kërkohet të ndërhyhet për lartësimin e argjinaturës së Pentarit, Shirqit dhe Darragjatit. Rrugët Shirq-Darragjat; Belaj-Pentar, Bishti i Qarrit dhe Urrela janë të bllokuara. Në ambientet e disa shkollave ka prezencë uji, ndërsa kanë rënë disa shtylla të energjisë elektrike në rrugën e Dajçit. Paraqitet shumë e nevojshme vendosja e shenjave orientuese në rrugë për të bërë të mundur kalimin. Janë mbi 300 shtëpi të rrethuara nga uji. Kërkohet furnizim me ujë të pijshëm për banorët. Në njësinë administrative Ana e Malit janë përmbytur 1300 ha tokë. Ujësjellësi 'Oblika 1' dhe 'Oblika 2' janë jashtë funksionit. Kërkohet furnizimi me ujë të pijshëm për banorët dhe nevojiten çizme të gjata për banorët. Lagjja Goricë është totalisht e izoluar. Janë 177 shtëpi të rrethuara nga uji, 150 në Obot dhe 27 në Goricë. Në njësinë administrative Bërdicë janë përmbytur mbi 1280 ha tokë. Stacioni i pompave të Ujësjellësit në Trush si pasojë e përmbytjeve është jashtë funksionit. Janë 100 shtëpi të rrethuara nga uji. Në njësinë administrative Velipojë janë të përmbytura mbi 410 ha tokë. Në fshatin Luarz, del uji nën argjinaturë. Ndërsa, në atë të Çasit paraqiten shumë probleme. Fshati Luarz është pa energji elektrike. Në njësinë administrative Rrethina janë të përmbytura 70 ha tokë. Në zonën e Livadheve janë 17 shtëpi të rrethuara nga uji. Në 3 shtëpi ka hyrë uji brenda. Në njësinë administrative Gur i Zi vazhdon gërryerja e tokës në fshatin Juban, në afërsi të Malit të Vukatanës. Në qytetin e Shkodrës, e konkretisht në zonën e Livadheve janë të përmbytura 135 ha tokë. Në këtë rrugë ndodhen mbi 70 shtëpi me prezencë uji afër oborreve të tyre. Me shumë vështirësi kalohet me makinë ushtrie, ndërsa në disa zona kalimi bëhet i mundur vetëm me varkë. Në lagjen "Ajasëm" janë rreth 3 ha tokë e mbuluar nga uji. Në 13 banesa ka prezencë uji. Bashkia Shkodër ka bërë evakuime të banorëve dhe gjësë së gjallë kur janë paraqitur nevoja, ndërsa 69 persona të akomoduar në konvikt. Gjithashtu, Bashkia Shkodër ka bërë të mundur edhe lëvizjen e banorëve dhe akomodimin e tyre tek të afërmit e tyre. Ndërkaq, specialistët tanë janë në terren, dhe po bëjnë vlerësimet e dëmeve të shkaktuara.

### MSH: Po monitorohet uji i pijshëm në zonat e përmbytura

## Ushtria shpëton 3 pacientë me dializë nga fshatrat: Dajç, Pentar dhe Velipojë



**SHKODËR** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka njoftuar se ka shpëtuar 3 pacientë dializantë në zonën e Shkodrës, e cila prej disa ditësh ndodhet nën pushtetin e ujit për shkak të përmbytjeve. Tre pacientë dializantë u transportuan sot me autoambulancë nga fshatrat Dajç, Pentar dhe Velipojë me ndihmën e ushtrisë dhe aktualisht po marrin shërbimin e dializës në spitalin e Shkodrës. Sipas njoftimit të ministrisë të gjitha strukturat shëndetësore pranë zonave të përmbytura janë në gatishmëri të plotë. "Me herët, 3 pacientë me probleme kardiake dhe bronkopneumoni u asistuan nga mjeku i qendrës shëndetësore Dajç, Besnik Haxhia dhe më pas kanë marrë shërbim të specializuar në spitalin e Shkodrës. Po monitorohen rregullisht nga ekipi i mjekëve edhe 70 të evakuuarit që janë vendosur në Konviktin e Shkollës Industriale. Nga masat e marra nga strukturat e shëndetësisë, është vendosur shërbim 24 orë në qendrat shëndetësore Dajç dhe Bërdicë. Ndërkohë 2 autoambulanca janë vendosur në gatishmëri 24 orë në kryqëzimin e Dajçit dhe në Malin Kolaj, ku janë edhe pikat e ushtrisë. Nga ana tjetër, strukturat e shëndetit publik po kryejnë monitorimin e situatës së ujit të pijshëm në të gjithë zonat e përmbytura", - thuhet ndër të tjera në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë.

**MIRDITË/KUKËS**

Shirat e rrëmbyer kanë shkaktuar shembje të dherave në Rrugën e Kombit (në afërsi të Repsit), ku për pasojë është dëmtuar një biznes. Ulja e temperaturave ka rikthyer reshjet e dëborës në qarkun e Kukësit, fenomen që ka risjellë probleme me qarkullimin e mjeteve.

**SHKURT**

### Kontrabandë cigaresh nga Mali i Zi, ndalohen 4 persona

**SHKODËR** - Policia dhe prokuroria e Shkodrës kanë finalizuar operacionin e koduar "Vijimësia" duke ndaluar katër persona të akuzuar për kontrabandë me mallra, për të cilat paguhet akcizë. Bëhet fjalë për shtetasit: Aleksandër Kontiç, 54 vjeç, banues në Grilë në fshatin Boriç i Vogël në Malësinë e Madhe, por rezident në Malin e Zi; Edmond Gjolajn, 44 vjeç, banues në Bogiq Polvar të Malësisë së Madhe; Ardian Okaj, 45 vjeç, banues në lagjen "Skënderbeg" në Shkodër dhe Albert Hasanaj, 45 vjeç, banues në Kamicë të Malësisë së Madhe. Sipas policisë, gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 90 koli me cigare, rreth 15 mijë euro, 7 telefona celular dhe 3 automjete. Po sipas bluve, katër personat e mësipërm u kapën, pasi dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë organizuar kontrabandim të cigareve të markave të ndryshme nga Mali i Zi për në Shqipëri, duke importuar dhe transportuar në rrugë ilegale, jashtë pikave doganore, kryesisht në zonën kufitare të Malësisë së Madhe, nga kufiri i gjelbër dhe me mjete lundruese nëpërmjet liqenit të Shkodrës. Mësohet se katër të arrestuarit, pasi i magazinonin kolitë me cigare në zonën e Malësisë së Madhe i shpërndanin ato sipas porosive në tregun e brendshëm, duke i tregtuar tek persona të tjerë në Shkodër dhe në qytetet e tjera të vendit, si Tiranë, Durrës apo Lezhë. Ata akuzohen për veprat penale: "Kontrabandë me mallra, për të cilat paguhet akcizë"; "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"; "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë" dhe "Ruajtja ose depozitimi i mallrave kontrabandë".

### Shpërdoroi detyrën, arrestohet noteria

**SHKODËR** - Një notere nga Shkodra ka përfunduar në pranga, pasi akuzohet për shpërdorim detyre. Burime nga policia lokale bënë me dije se është arrestuar 44-vjeçarja Majlinda Dibra, banuese në lagjen "Qemal Stafa" të këtij qyteti. Mësohet se arrestimi i 44-vjeçares u bë me kërkesë së prokurorisë pas dyshimeve për falsifikim të dokumenteve të pronësisë (një pronë të trashëguar). Pronari i pronës është ndarë nga jeta dhe përpara se të vdiste është paraqitur tek noteria Dibra duke i lënë me testament shtëpinë djalit të tij. Ndërkaq, ish-gruaja e personit që ka ndërruar jetë, pretendon që të marrë gjysmën e shtëpisë.

INTERVISTA

# ALFRED BUALOTI:

## Teatri Kombëtar nuk bëhet me dhunë, të zgjidhet projekti më i mirë mes disa variantesh

Fatmira Nikolli

Prej ditës kur kryeministri Edi Rama ka prezantuar projektin për Teatrin Kombëtar, zërat kundër modelit kanë qenë disa. Jo doemos me modelin, artistët kanë kundërshtuar modelin e Partneritetit Publik Privat, për ndërtimin e godinës.
Duke kërkuar qoftë të pritet më gjatë, derisa të sigurohen të ardhurat, ose duke shpallur nisma për sigurimin e një shume parash nga populli për ndërtimin e një Teatri Kombëtar, aktorët janë bashkuar në një Aleancë për Mbrojtjen e Teatrit për të kundërshtuar projektin e qeverisë. Emra të njohur nga Robert Ndrenika, Bujar Asqeriu, Afben Derhemi, Ndriçim Xhepa, Roza Anagnosti e të tjerë kanë kundërshtuar në forma të ndryshme projektin që kërkohet t'u imponohet, edhe pse u qe premtuar se do të hapej një konkurs me disa projekte, mes të cilëve do zgjidhje më i miri. Nuk u hap një konkurs, përkundrazi, ishte shefi i qeverisë që doli me një projekt të përzgjedhur prej tij (nuk dihet kur u porosit, as nga kush u porosit, as si u ra dakord) me të cilin artistët u njohën si me një projekt të përfunduar.

Prej asaj dite, në forma të ndryshme, artistët kanë qenë kundër. Ka pasur sigurisht edhe emra pro shembjes së TK dhe pro projektit të ri, por këta kanë qenë më të pakët. Ajo që duket jashtë këtij procesi, duket Ministria e Kulturës që në gjithë këtë kohë, së paku publikisht ka qenë vëzhguese e jo aktori në çështje.

Sot "Gazeta Shqiptare" sjell intervistë me Alfred Bualotin për çështjen e teatrin. Regjisori refuzon të pranojë një projekt të ofruar përdhunshëm si të vetmen mundësi.

**-Si e keni parë debatin për çështjen e Teatrit Kombëtar?**

Siç e dini, unë nuk kam folur deri tani për çështjen e Teatrit, edhe pse nuk e kam ndjekur nga afër duke mos qenë në Tiranë. Nuk mund të them se kam ndonjë gjë në mënyrë konkrete. Por, unë si Alfred, sigurisht duke qenë mjaft gjatë në atë teatër, i di gjithçka se çfarë ndodh së paku me godinën e tij. Thënë kjo, di po ashtu çdo gjë që lidhet me historinë e tij. Historia është tjetër gjë, historia është e madhe, ka qenë gjenezë e disa institucioneve, për ç'arsye edhe mund ta ruash në muze, mund të bësh shumë gjëra, por ai teatër nga pikëpamja teknike, nga pikëpamja e infrastrukturës, ai teatër duhet të rrafshohet pa diskutim.

**-Flisni për gjendjen?**

Po, ai teatër nëse flasim për gjenden e tij, nuk vlen më asnjë grosh. Por, po flasim vetëm për nga infrastruktura, sidomos për çfarë kërkon koha sot, me çfarë kërkon teatri sot, ai teatër nuk plotëson asnjë kusht. Asnjë kusht nga çfarë kërkon spektatori i sotëm, sepse bota ka ecur para. Nuk jemi më në vitet '60, '70 që bënim teatër siç bëhej. Sigurisht ishte i mirë teatri i asaj periudhe, por u mbyll, iku. Tani ka ecur përpara. Në shumë gjëra, edhe teknikisht. Pra, duhet bërë ai teatër, duhet ribërë. Kur flasim se si duhet ribërë, hajde të flasim e ta hedhim me konkurs.

**-Si ju është dukur projekti i prezantuar nga qeveria?**

Nuk po flas për të. Nuk më intereson të shoh një projekt të vetëm, një projekt i përdhunshëm, që të thonë, 'është ky projekt dhe nuk ka më'. Absolutisht. Unë jam për t'u hapur një konkurs, për të pasur disa variante dhe vetë specialistët me në krye kë të doni ju nga teatri, të vendosin që cili variant është më i miri për Teatrin Kombëtar. Maks Velo e ka shprehur këtë me sa di unë, Stefan Çapaliku po kështu. Janë disa njerëz që janë marrë me këto çështje dhe janë në kontakt edhe me Europën dhe dinë çfarë thonë.

> *"Rama ishte i dhunshëm, nuk më intereson të shoh një projekt të vetëm, që të thonë 'është ky projekt dhe nuk ka më'"*


Alfred Bualoti

**-Duhet të jenë disa projekte?**

Duhet të jetë një konkurs i hapur me 3-4, 2 ose 5, a më shumë studio të shqiara arkitekture, ku mund të jetë edhe një studio shqiptare pse jo, me një projekt për teatrin.

**-Duhet të jetë një projekt shqiptar?**

Ne kemi arkitektë shumë të mirë. Le të mendojnë dhe le të shohim se si mund të bëhet teatri. Pastaj, një teatër i vërtetë kombëtar, në kuptimin e ndërtesës e të siguracionit e të sallave nëse do të ketë disa salla brenda; në kuptimin e ambienteve, apo të muzeut, sepse duhet të ketë një muze brenda për të ruajtur kujtesën. Nëse do të ikë ajo godinë e vjetër, duhet të ruhet diçka siç kanë teatrot e tjerë.

**-Nëse do ndërtohet një Teatër Kombëtar, si duhet të jetë?**

Nëse doni referenca nuk është për t'u çuditur. Referencat i keni në Shkup, i keni në Podgoricë, i keni në Beograd, i keni në Kroaci, i keni ku të doni. Nuk keni nevojë të shkoni më tutje, nuk keni nevojë të shkoni në Perëndim, a ku di unë edhe më larg. Se ka shumë që marrin referenca Broduejin e Nju Jorkut. Ky nuk është një rast që merret për bazë.

Ne po flasim për një vend siç jemi ne, siç janë fqinjët tanë, siç është rajoni ynë, siç ka një kulturë, një histori e një filozofi të vetën e një karakter të vetin. Eja ta ndërtojmë teatrin mbi këtë bazë. Ne nuk ia kalokemi dot Maqedonisë, që ka bërë një teatër me 30 milionë euro? Kam qenë në atë ndërtesë e kam parë shfaqje, është një mrekulli. Nëse nuk e bëjmë dot ashtu, le të bëjmë diçka po aq të mirë, në një farë mënyre të tillë. Pastaj, se çfarë do të bëhet pas teatrit a para teatrit, nuk më intereson fare.

Dua të di vetëm çfarë do bëhet me Teatrin Kombëtar, cila është godina që do të ketë ai.

**-Çështja e PPP-ve ka qenë tejet e debatuar. Artistët kanë frikë për humbjen e truallit, ju si e shihni këtë?**

Unë nuk di të them a humb truall teatri a jo. Mua, te ky variant a te një tjetër, ajo që më intereson, është të dalë në pah Teatri Kombëtar dhe më pas konfigurimi pas tij, a në krah të tij. Dua që të ketë një teatër kombëtar të mirë. Atë projekt e pashë shkarazi. E pashë si dhunë, është ky e s'ka tjetër, por unë nuk mundem ta pranoj më dhunë. Sepse nuk mund të thotë askush 'është ky e nuk ka tjetër'. Secili duhet ta japë një mendim për një çështje të rëndësishme si teatri. Nuk bëhet kështu, ky është dhe nuk ka tjetër, ky është e vrisni veten. Për këtë nuk jam. Jam që të ndërtohet diçka e bukur, diçka funksionale, diçka që i përket kohës dhe të zgjedhin më të mirën mes disa varianteve ata.

**-Ju mbani mend edhe debatin e 20 viteve më parë. Përsëritet e njëjta situatë, apo jo?**

Ajo e 1999-ës ishte diçka që nuk e kam kuptuar fare, sepse ajo shkoi në një rrokopujë të tmerrshme. Erdhën e vetëm thanë do ndërtohet. Do futet teatri brenda në kullë, a do dalë teatri nga kulla - ishte një rrokopujë që nuk ka më rëndësi. Ajo ishte një gjë që nuk duhet përmendur e nuk duhet kujtuar fare. Ajo ashtu shkoi, ashtu shkoi siç filloi, edhe mbaroi. Nuk u bë asgjë. Tani kjo ka hapur një debat, hajde ta rikthejmë e ta bëjmë si duhet.

**-Artistët kanë kritikuar sjelljen e kryeministrit, e kanë cilësuar fyese...**

Absolutisht ishte i dhunshëm për mua. Absolutisht i dhunshëm. Nuk duhej kështu. Nga njëra anë ai ka futur konkursin, që çdo gjë duhet bërë në konkurs e nga ana tjetër nuk ka konkurs për teatrin. Nuk po bëjmë bibliotekë në një lagje të Tiranës. Po flasim për një problem të rëndësishëm, kombëtar, ndaj pse të mos ketë konkurs? Pse duhet të ketë dy lloje sjelljesh?

Duhet të jetë një godinë që t'i shërbejë një shekulli a më shumë. Ka shtete që kanë teatro prej shekujsh, ne po flasim që të ndërtojmë një teatër që të mund të rezistojë me shekuj dhe të mendohet për një gjë të mbarë dhe të mendohet për këtë çështje më parë.

Do të kishte studio që do të ishin shumë të interesuara të ofronin projekte për teatrin, jam i bindur për këtë. Nuk ka më vende që kanë mbetur pa ndërtuar teatër kombëtar. Teatrot janë ndërtuar në të gjitha shtetet, ndaj studiot do të jenë të interesuara të japin kontributin e tyre për një teatër që do jetonte me shekuj. Mezi e presin këtë.




Projekti i Teatrit Kombëtar

Pas konfliktit të gjatë me Maqedoninë, ja emri që do t'i japë zgjidhje

# Një javë para finales, Kotzias në Shkup për çështjen e emrit

## *Raundi i ri i diskutimeve zhvillohet në Vjenë*

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias viziton ditën e sotme vendin fqinj, Maqedoninë. Pritet që ai të sjellë me vete një zgjidhje kompromisi për çështjen e emrit. "Gorna Makedonija" - Maqedonia e Epërme duket të jetë formula magjike, me të cilën do të zgjidhet pas 27 vjetësh konflikti për emrin mes Greqisë dhe Maqedonisë. Këtë e ka sinjalizuar pala greke në raundin më të ri të negociatave nën ndërmjetësimin e OKB-së. Mediat greke shkruajnë se ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias do të përpiqet për këtë kompromis të enjten në Shkup. Pala greke kërkon që nocioni sllav të mos përkthehet. Po pse? Për Spiros Danellis, deputet i Partisë Social-liberale To Potami në bisedë me Deutsche Welle-n e kritikon këtë si "një shenjë tjetër të mendimit irracional, që është tipike për mënyrën e perceptimit nga ana jonë të grindjes për emrin. Ai thotë se nuk e kupton këtë lloj të menduari. "Nëse formula e kompromisit "Gorna Makedonija pranohet nga të dyja palët dhe kontribuon që të zgjidhet çështja e emrit, atëherë sigurisht që varianti duhet të merret". Por mbetet me pikëpyetje, nëse Maqedonia bie në ujdi me emrin Maqedonia e Epërme. Edhe nëse ajo bie dakord, konflikti nuk zgjidhet menjëherë. Jorgos Tzogopoulos, docent për marrëdhëniet ndërkombëtare në Universitetin e Trakisë thotë se më e rëndësishme se ndërmjetësimi i OKB-së është që vendi fqinj të sanksionojë me Kushtetutë emrin e ri të shtetit. Kushtetuta, përveç kësaj, do ndryshuar edhe në atë mënyrë që të përjashtohen pretendimet territoriale ndaj Greqisë, thotë eksperti. Ndërkohë që nga ana tjetër ka pasur kërcënime kundër ministrit të Jashtëm. Sipas palës greke ka arsye historike për këtë frikë. Maqedonia një ditë mund të ngrejë pretendime ndaj provincës greke me të njëjtin emër dhe kryeqytetit të saj Selanik. Kjo është arsyeja, pse Greqia nuk e ka njohur vendin fqinj me emrin kushtetues, Republika e Maqedonisë, por me emrin FYROM, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë. Që nga viti 1991 zhvillohen bisedime për çështjen e emrit. Greqia kundërshtonte një kohë të gjatë çfarëdolloj përdorimi të nocionit "Maqedoni" në emrin e vendit fqinj. Por ndërkohë që sinjalizohet gatishmëri për kompromis, opinioni publik grek nuk e mbështet i gjithi këtë gatishmëri. Në një sondazh të fundit të televizionit Alpha, 60% e të anketuarve u shprehën, se janë kundër përdorimit të nocionit "Maqedoni" në emrin e shtetit fqinj. Por 67% dëshirojnë që negociatat të vazhdojnë. Kundërshtimet kanë mbetur në nivelin e protestave, por në fillim të shkurtit, ministri i Jashtëm grek Kotzias mori një letër ku shkruhej se janë gati "tre plumba për atë dhe familjen e tij". Edhe deputeti Danellis ka marrë kërcënime, pasi u shpreh hapur për një kompromis për çështjen e emrit. Danellis mendon, se politikanët e moderuar nga të dyja anët duhet të shfrytëzojnë këtë moment. "Nëse edhe Zoran Zaev arrin të bëjë një kompromis tek njerëzit e tij, gjë që nuk është e lehtë, atëherë do të kemi një zgjidhje për çështjen e emrit që para verës." Kotzias duhet të mbarojë punë. Sipas zëdhënësit të qeverisë greke, Dimitris Tzanakopoulos, ministri i Jashtëm grek, Kotzias ka një paketë të kompletuar kompromisi "në pajtim me pozicionet e qarta të negocimit të qeverisë greke". Këto propozime i bisedon Kotzias në Shkup të enjten. Mediat greke raportojnë, se pala tjetër i ka formuluar propozimet e saj për zgjidhjen e konfliktit. Më së vonë, më 30 mars, ndërmjetësuesi Mathew Nimetz do të thërrasë në Vjenë një raund të ri bisedimesh për çështjen e emrit. "Planmarrëveshja parashikon për ish-Republikën jugosllave të Maqedonisë një "emër të përbërë" duke e bashkuar emrin Maqedoni me një përcaktues, të tipit Maqedonia e Epërme, që do të përdoret sipas kushtit "erga omnes", si ndërkombëtarisht ashtu dhe brenda shtetit fqinj", theksoi Dimitris Tzanakopoulos, zëdhënës i qeverisë greke në një konferencë shtypi. "Një zgjidhje e tillë do të nënkuptonte rishikim të Kushtetutës nga vendi fqinj",-nënvizoi ai, ndërkohë që qeveria maqedonase nuk disponon maxhorancën parlamentare të mjaftueshme për të kryer më mirë një procedurë të tillë. "Athina pret tashmë komente dhe mendime nga pala tjetër",-theksoi Dimitris Tzanakopoulos.

**SPIROS DANELLIS**
"Një shenjë tjetër të mendimit irracional, që është tipike për mënyrën e perceptimit nga ana jonë të grindjes për emrin. Nuk e kuptoj këtë lloj të menduari. Nëse formula e kompromisit "Gorna Makedonija", pranohet nga të dyja palët dhe kontribuon që të zgjidhet çështja e emrit, atëherë sigurisht që varianti duhet të merret."



### Jeremiç i zbulon udhëtimin "sekret" në SHBA, reagon presidenti

## Vuçiç: Dua t'ia shkul vetes flokët, shqiptarët e ndërkombëtarët po qeshin me ne



**ALEKSANDAR VUÇIÇ:**
"Ne e kemi mbytur veten me vendimet tona. Do t'ia kisha shkulur vetes tani flokët për shkak të Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë. Po qeshin me ne shqiptarët për këtë, po qeshin ndërkombëtarët. Mbrëmë në një darkë të rëndësishme me përfaqësues të një shteti perëndimor, 5 herë këtë ma kanë përmendur", -ka thënë presidenti serb.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, i cili u zbulua se udhëtoi drejt SHBA-së tinëz bashkë me vajzën e tij, për takime me zyrtarë amerikanë në lidhje me Kosovën i është përgjigjur ish-shefit të diplomacisë serbe, Vuk Jeremiç, i cili ia zbuloi këtë udhëtim. Vuçiç e ka goditur Jeremiçin për rastin e Kosovës në Gjykatën ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila kishte vendosur në favor të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kjo edhe për shkak të formulimit jo të duhur nga ana e Serbisë. Jeremiç ishte identifikuar me këtë dështim të Serbisë në vitin 2010. "Ne e kemi mbytur veten me vendimet tona. Do t'ia kisha shkulur vetes tani flokët për shkak të Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë. Po qeshin me ne shqiptarët për këtë, po qeshin ndërkombëtarët. Mbrëmë në një darkë të rëndësishme me përfaqësues të një shteti perëndimor, 5 herë këtë ma kanë përmendur. E unë si kokëtrashë e nxora Marrëveshjen e Kumanovës dhe Rezolutën 1244 dhe u thashë: Ejani ta zgjidhim këtë kontest ndërmjet nesh dhe jush, duam ta zgjidhim kontestin me shqiptarët",-ka thënë Vuçiç pa e përmendur Jeremiç. Vuçiç duke folur me tej për këtë vizitë në televizionin publik serb ka thënë se nuk është i kënaqur me rezultatet e vizitës në SHBA pasi, sipas tij, askush atje nuk ka dashur të diskutojë se kujt i përket territori i Kosovës. Ai, po ashtu, duke përmendur takimet me Thaçin, i cili, po ashtu, ndodhet në SHBA, ka thënë se me Thaçin asnjëherë nuk është takuar pa prani ndërkombëtare, por nuk ka mohuar që kjo të ketë ndodhur në Amerikë.

## SHKURT

### Daçiç propozon Beogradin për takimin Trump-Putin: Jemi të përgatitur

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç propozoi Beogradin si vendin e duhur për një takim të mundshëm mes presidentit amerikan, Donald Trump dhe homologut të tij rus, Vladimir Putin. "Beogradi është absolutisht i përgatitur për të organizuar një takim të tillë të një rëndësie planetare", deklaroi Daçiç. "Si një vend ushtarakisht neutral, Serbia ka kapacitetet e politikës së jashtme për të mikpritur presidentët e SHBA-së dhe Rusisë", shtoi ai, raporton ata. Pak muaj më parë, në Beograd u takuan ambasadorët amerikan, Kurt Volker dhe ai rus, Vladislav Surkov, të cilët diskutuan për krizën ukrainase.

### Ndërhyrja ruse, jep dorëheqjen avokati i presidentit Trump

Avokati që përfaqëson Presidentin Donald Trump në çështjen për hetimin e ndërhyrjes ruse në zgjedhjet amerikane, ka dhënë dorëheqjen. Mediat amerikane raportojnë se avokati John Dowd është dorëhequr me arsyetimin se Presidenti Trump nuk dëgjonte asnjëherë këshillat e tij. John Dowd, avokati kryesor i Trump, ka pasur kundërshtime me anëtarët e tjerë të ekipit ligjor të Presidentit, që ky i fundit të jepte një intervistë. Dowd ka kundërshtuar kategorikisht, ndryshe nga anëtarët e tjerë të Presidentit amerikan.

### Sarkozy mohon akuzat: Ma kanë bërë jetën ferr

Ish-presidenti francez, Nikolas Sarkozi është zyrtarisht nën hetim për përfitime të financimeve të paligjshme nga ish-udhëheqësi libian Muamar Gedafi. Por të mërkurën, Sarkozi mohoi akuzat përpara hetuesve parizienë duke thënë se ato ia kishin bërë jetën ferr që prej 2011-ës. E përditshmja franceze "Le Figaro", ka zbardhur dëshminë e tij gjatë marrjes 2 ditore në pyetje. Sarkozi akuzohet se ka përfituar deri 50 milionë euro nga qeveria libiane në formë financimesh për fushatën elektorale të vitit 2007, çka ndalohet nga ligji zgjedhor francez. Por ish-presidenti tha para hetuesve se ishte akuzuar pa asnjë provë fizike. Sarkozi thotë se nuk e ka takuar kurrë personalist biznesmenin franko-libanez Ziad Takieddine. Ishte Takieddine që e bëri publike aferën në një intervistë në vitin 2012 dhe konsiderohet si ndërmjetësuesi i Sarkozisë në çështjet financiare të kësaj afere.

# Kosova hyn në axhendën për anëtarësim në INTERPOL



Shteti i Kosovës shumë shpejt mund të jetë pjesë e INTERPOL-it nëse i siguron votat e mjaftueshme të shteteve anëtare. Sekretari i Përgjithshëm i INTERPOL-it, Jurgen Stock, e ka njoftuar ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefajn, se anëtarësimi i Kosovës ka hyrë në agjendën e INTERPOL-it - Policisë Ndërkombëtare. Gjithçka do të ndodhë në Dubai, në nëntor të këtij viti. Në letrën njoftuese drejtuar ministrit të Brendshëm të Kosovës, Stock, thotë se ndihet i nderuar që për këtë është diskutuar në Komisionin Ekzekutiv të INTERPOL-it, i cili e ka pranuar aplikacionin e Kosovës, raporton Express. Stock, në letër ka shprehur falënderim për interesimin që, sipas tij, e ka dëshmuar Republika e Kosovës për t'iu bashkuar INTERPOL-it. Vitin e kaluar autoritetet në Kosovë deklaruan se kishin hequr dorë nga anëtarësimi në INTERPOL, Asambleja e Përgjithshme e së cilës u mbajt në 26 deri 27 shtator 2017, për shkak se nuk kishte votat e mjaftueshme. Kjo është letra e plotë e sekretarit të përgjithshëm: I nderuar ministër, I referohem aplikacionit në pritje për anëtarësim në INTERPOL nga Republika e Kosovës. Jam i nderuar të ju njoftoj se Komisioni Ekzekutiv i INTERPOL-it, në takimin më 6-8 mars, gjatë sesionit të 197-të, ka diskutuar aplikacionin për anëtarësim të Republikës së Kosovës në INTERPOL. Në përputhje me dispozitat e artikullit të katërt të Kushtetutës së INTERPOL-it dhe Rezolutës së Përgjithshme të Asamblesë GA-2017-86-RS-01, aplikacioni i Republikës së Kosovës për INTERPOL është vendosur që të shqyrtohet në agjendën e përkohshme të sesionit të 87-të të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it. (25)

### Ndërpritet seanca për të katërtën herë, ja sa dënohen 7 të arrestuarit

# Hodhën gaz lotsjellës në Kuvend, Vetëvendosje: Të lirohen deputetët

## *Parlamenti i Kosovës miraton demarkacionin*

Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar lirimin e menjëhershëm të deputetëve të arrestuar të mërkurën, të cilët hodhën gaz lotsjellës në Kuvend. Vetëvendosje thekson se ky arrestim i deputetëve ka ndodhur me urdhër, siç e quan Vetëvendosje "kryepolicit Kadri Veseli". "Dje, në seancën për demarkacionin me Malin e Zi, u arrestuan 7 deputetë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! të cilët protestuan brenda Kuvendit kundër kësaj marrëveshje që ia fali 8200 hektarë Malit të Zi dhe ia zgjati jetën kësaj qeverie për pak kohë. Ky arrestim i deputetëve të Lëvizjes erdhi me urdhër të kryepolicit Kadri Veseli për të liruar sallën e Kuvendit të Republikës që dje kishte për qëllim faljen e territorit, legjitimin e tradhtisë së Thaçit, e të gjitha këto me ndihmën e kryeministrit Haradinaj", thuhet në reagim. "Deputetët që u arrestuan dhe u larguan dhunshëm nga salla e Kuvendin ende po vazhdojnë të mbahen në paraburgim vetëm pse u vunë në mbrojtje të Republikës. Ne kërkojmë lirimin e menjëhershëm të deputetëve: Arbërie Nagavci, Drita Millaku, Fitore Pacolli, Liburn Aliu, Valon Ramadani, Salih Zyba dhe Xhelal Sveçla", thuhet në reagimin e VV-së. Ndërkohë që prokuroria e Kosovës u ka vendosur masën e ndalimit për 24 orë 7 deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët hodhën dje gaz lotsjellës në Kuvend, gjatë kohës që tentohej të votohej marrëveshja e kufirit me Malin e Zi. Lajmin për Telegrafin e ka konfirmuar zëdhënësi i Prokurorisë, Ekrem Lutfiu. Drita Millaku, Fitore Pacolli, Arbërie Nagavci, Liburn Aliu, Salih Zyba, Xhelal Sveçla, dhe Valon Ramadani janë deputetët e Vetëvendosjes, të cilëve iu është caktuar 24 orë ndalim policor. Pas një seance maratonë, Kuvendi i Kosovës ka arritur të ratifikojë marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Me 80 vota pro, 11 kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit i dhanë dritën jeshile kësaj marrëveshje. Gjatë seancës së sotme u hodh katër herë gaz lotsjellës nga deputetët e Vetëvendosje të cilët kundërshtojnë këtë marrëveshje, por në fund është arritur që të miratohet me 80 vota pro. Pesë deputetët e Vetëvendosjes u përjashtuan dhe disa prej tyre u arrestuan. Marrëveshja e Demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit ishte firmosur në Vjenë më 26 gusht të vitit 2015 nga Presidenti i tanishëm, Hashim Thaçi asokohe, ministër i Jashtëm, dhe ish-ministri i Brendshëm, Skënder Hyseni. Për palën malazeze firmosën ministri i Jashtëm, Igor Llukshiç, dhe ai i Brendshëm, Rashko Konjeviç. Që nga ajo kohë, kjo ujdi ka hasur në kundërshtime të mëdha të opozitës me arsyetimin se Kosova po humb 8 mijë hektarë tokë. Në mesin e atyre që ishin kundër Demarkacionit ishte edhe kryeministri aktual, Ramush Haradinaj në kohën kur ishte në opozitë. Haradinaj në ditën e parë të punës në krye të ekzekutivit ka shkarkuar komisionin për shënimin e kufirit duke emëruar Shpejtim Bullicin si udhëheqës të ekipit të ri. Pas votimit të Demarkacionit, lufta kundër krimit dhe korrupsionit mbetet kushti vetëm i Bashkimit Evropian për t`u hequr vizat shqiptarëve në Kosovë.



## NEW YORK, MAGJI NË CENTRAL PARK, PARKU MBULOHET NGA 'DËBORA E PRANVERËS'

**Dëbora ka mbuluar brigjet lindore të Shteteve të Bashkuara, duke sjellë erëra të ftohta të cilët kanë goditur qytetin e Bostonit, New York-ut dhe Washington. Shumë shkolla janë mbyllur dhe probleme janë shkaktuar në transport dhe rreth 5000 fluturime janë anuluar. Por pavarësisht të gjitha problemeve dëbora ka dhuruar edhe skenare përrallore dhe shembulli është kjo video e postuar në "Facebook", ku duket Central Park-, parku më i madh në Manhattan, në New York, plotësisht i zbardhur nga dëbora.**




## SHKURT

### Makina pa shofer përplas për vdekje gruan, policia publikon videon

Ky është aksidenti tragjik i ndodhur në Arizona të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur një makinë pa shofer Uber përplas për vdekje një grua me biçikletë që po kalonte rrugën. Viktima, e identifikuar si Elaine Herzberg, humbi jetën si pasojë e plagëve të marra pak minuta pas aksidentit. Pamjet janë publikuar nga policia e Arizonës dhe janë marrë nga kamerat e sigurisë të vendosura në pjesën e brendshme të makinës dhe në pjesën e jashtme te saj. Në pamjet filmike duket Herzberg që del papritur para makinës teksa ecte me biçikletën në dorë. Dhe më pas kamera e vendosur brenda automjetit tregon reagimin e Rafaela Vasquez, personi që po testonte makinën. Ajo duket qartë që nuk po shikonte rrugën në momentin e aksidentit dhe sigurisht nuk arriti të menaxhonte situatën.

### Akuzohet për korrupsion, kërkohet arrestimi i ish-presidentit të Koresë së Jugut

Një gjykatë koreanojugore nxori sot një mandat arresti kundër ish-presidentit Lee Myung Bak, disa ditë pasi ishte marrë në pyetje nga prokurorët në lidhje me akuza për korrupsion, njoftoi agjencia zyrtare koreanojugore e lajmeve "Yonhap". President në vitet 2008-2013, Lee Myung-bak, 76 vjeç, është i fundit i një serie kryetarësh në Korenë e Jugut të përfshirë në një hetim kriminal, për korrupsion me vlera që arrijnë disa milionë dollarë. Lee dyshohet se ka marrë shuma parash nga shërbimet sekrete, kompani dhe organizata të tjera që arrijnë vlerën e 11 miliardë uon (10,2 milionë dollarë). Edhe Park Geun Hye, që pasoi Lee si president, e cila u shkarkuar në mars 2017, është, gjithashtu, duke u përballur me akuza për korrupsion.

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

# ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

## Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shoqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

**KOMPENSIMI FINANCIAR**

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar për tokën truall rezulton se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezulton se pjesa e mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

**KOMPENSIMI FIZIK**

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesi a | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|

*(Vijon nga numri i djeshëm)*

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesi a | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Tiranë | RAMAZAN SENA | | | 1,104,989 |
| Tiranë | SHABAN KAÇERRI | | | 2,544,822 |
| Tiranë | SHABAN KAÇERRI | | | 1,754,588 |
| Tiranë | RAMAZAN ABAZI | | | 1,674,225 |
| Tiranë | REXHEP SPAHIU | | | |
| Tiranë | REXHEP SPAHIU | | | 20,291,607 |
| Durrës | Sotir Karroqja | | | |
| Durrës | Nikolla Mihal Shani | | | |
| Durrës | Xhelal Elezi | | | 4,764,000 |
| Durrës | Lulëzim Elezi | | | EZAURUAR |
| Durrës | Liman Kulla | | | |
| Durrës | Anton Albert Akshia | | | |
| Durrës | Klara Gurashi | | | 2,417,700 |
| Shkodër | Trashegimtaret Ulaj | | | |
| Tiranë | | | | |
| Tiranë | KALEM KUCI | | | |
| Tiranë | RAMAZAN REXHA | | | |
| Tiranë | GANI HEMA | | | 11,384,730 |
| Tiranë | INAJET DELVINA | | | |
| Korçë | Selami Pysqyli | | | |
| Korçë | Fatli Elezi | | | EZAURUAR |
| Korçë | Muhamer Venxha | | | |
| Korçë | | | | 76,900 |
| Korçë | Kostina Fani | | | EZAURUAR |
| Tiranë | | | | 27,591,228 |
| Tiranë | HASAN DIBRA | | | 6,027,210 |
| Tiranë | SKENDER KALENJA | | | 6,348,661 |
| Vlorë | Arif Berberi | | | |
| Tiranë | | | | |
| Korçë | Pertef Pupa | | | |
| Durrës | | | | |
| Durrës | | | | |
| Durrës | Aishe Zalla | | | |
| Durrës | | | | |
| Gjirokastër | Ali Shehaj | | | 1,288,105 |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesi a | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Dibër | BASRI SHEHU | | | |
| Dibër | SKENDER LAZRI | | | 87,680 |
| Dibër | HAKI SHEHU | | | 383,295 |
| Lezhë | Ndue Zef Shkurti | | | |
| Lezhë | Mark Ndue Gjoni | | | 86,024 |
| Lezhë | Zef Pjeter Doçi | | | |
| Lezhë | Doda Preng Rasha | | | |
| Lezhë | Gjon Llesh Drobi | | | |
| Shkodër | Shaban Sokoli | | | 11,501,843 |
| Shkodër | Shaban Sokoli | | | 14,960,952 |
| Shkodër | Ferit Baci | | | |
| Shkodër | Berhan Bushati | | | |
| Shkodër | Haki Hoxha | | | EZAURUAR |
| Shkodër | Geg Pali | | | |
| Tiranë | GEZIM MULLALLIU | | | 21,260,196 |
| Tiranë | TRASHEGIMATRET E SUBJEKTEVE TRA | | | 148,403,304 |
| Tiranë | ÇELO ZHUPA | | | |
| Tiranë | HAXHI ZHUPA | | | 17,746,785 |
| Berat | QEMAL SHEHU | | | |
| Tiranë | OSMAN MEHMET MUÇA | | | 2,430,975 |
| Tiranë | XHAFER SUBASHI | | | EZAURUAR |
| Tiranë | ASLLAN TAGANI | | | 33,149,655 |
| Elbasan | XHEMAL XHEPA | | | - |
| Elbasan | RUKIJE ABDURREZAKU | | | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Rrapo Hitaj | | | 1,333,636 |
| Korçë | Neim Panariti | | | |
| Korçë | Ollga Zoto | | | 76,440 |
| Korçë | Vasil Morcka | | | |
| Korçë | Lavderim Kulla | | | |
| Korçë | Mustafa Seit | | | 595,000 |
| Korçë | Urma Selimllari | | | 150,000 |
| Korçë | Agim Agolli | | | 253,700 |
| Korçë | Spiraq Çule | | | |
| Korçë | Andrea Tira | | | |
| Korçë | Erato Konomi | | | |
| Korçë | Theodhora Nikollara | | | |
| Korçë | Halim Çeliku | | | 239,400 |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesi a | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Korçë | Agim Llazi | | | |
| Shkodër | Cuf Shkreli | | | |
| Shkodër | Shaban Zaganjori | | | |
| Shkodër | Gezim Tahiri | | | |
| Shkodër | Kydret Zyberi (Gruda) | | | 8,306,736 |
| Shkodër | Ahmet Riza Raxhimi | | | |
| Shkodër | Liza Kola | | | 2,570,322 |
| Shkodër | Sabri Ymeri | | | 15,510,987 |
| Shkodër | Saime Nehani | | | 978,765 |
| Shkodër | Shuajp Rrjolli | | | 3,872,505 |
| Shkodër | Nazmi Muca | | | |
| Tiranë | Reshat Teliti | | | - |
| Tiranë | HYQMET MUKA | | | |
| Tiranë | SHPETIM TELITI, ETJ | | | 14,405,700 |
| Tiranë | REMZI KAPIDANI | | | EZAURUAR |
| Tiranë | BEDRIJE PETRELA | | | EZAURUAR |
| Tiranë | SHYQYRI SHKALLA (VORPSI) | | | |
| Korçë | Ramadan Zaçellari | | | 255,000 |
| Fier | Jorgji Roko | | | |
| Tiranë | ISLAM KUKA | | | 4,352,985 |
| Tiranë | HAXHI GRORI | | | 41,922,594 |
| Tiranë | ISMAIL BARONI (BAJRAMI) | | | 2,209,977 |
| Tiranë | SHEFIK HASANI | | | 17,368,868 |
| Tiranë | REXHEP TETOVA | | | |
| Tiranë | REXHEP TETOVA | | | |
| Tiranë | REXHEP TETOVA | | | |
| Korçë | Petro Argjiri | | | |
| Tiranë | KUJTIM, AVENIR KIKA | | | EZAURUAR |
| Tiranë | AVENIR KIKA | | | |
| Tiranë | RAMAZAN PETI | | | |
| Lezhë | Preng Dod Nikolli | | | |
| Elbasan | SHAQIR MUHARREMI | | | 2,186,560 |
| Elbasan | SHPETIM JOLLDASHI | | | 177,658 |
| Elbasan | LUAN KOTHERJA | | | 4,212,120 |
| Elbasan | KUJTIM LULJA | | | |
| Elbasan | FOTI ASIL NIKOLLA | | | 409,980 |
| Elbasan | FOTI ASIL NIKOLLA | | | 1,187,052 |
| Elbasan | ISMAIL QORRI | | | |

| | | |
|---|---|---|
| Tiranë | NAXHIJE JAUPI (DOMI) | |
| Tiranë | ABDYL JAUPI | EZAURUAR |
| Tiranë | SHAQIR KARABASHI | |
| Korçë | Hatixhe Progri | |
| Tiranë | HYSEN ISMAIL TUFINA | 3,569,448 |
| Tiranë | HYSEN ISMAIL TUFINA | 997,838 |
| Tiranë | HYSEN ISMAIL TUFINA | 66,969 |
| Tiranë | HYSEN ISMAIL TUFINA | 1,747,891 |
| Tiranë | ALBERT SAQELLARI | |
| Tiranë | RAKIP MINGA | 15,402,870 |
| Tiranë | RAKIP MINGA | 19,889,793 |
| Korçë | Bexhe Kolaneci | |
| Elbasan | TAIPE QYRA | |
| Elbasan | LAVER AHMATI | |
| Elbasan | HEKURAN ZENELI | 2,276,826 |
| Elbasan | SHEFQET CEKREZI | 1,610,041 |
| Elbasan | Hasim Shaliu | |
| Elbasan | Myfit Myftaraj | 5,936,010 |
| Elbasan | FETAH XHELILI | 4,013,718 |
| Elbasan | FAIL FEKA | 762,737 |
| Vlorë | Spiridhula Kacai | EZAURUAR |
| Dibër | LUAN REXHEPI | 99,324 |
| Dibër | SHKURTE CENI | 250,060 |
| Dibër | ALI GJECI | |
| Vlorë | Birac Shero | 79,350 |
| Vlorë | Ollga Diamanti | |
| Elbasan | XHEMAL XHEPA | |
| Elbasan | IBRAHIM DAIU | EZAURUAR |
| Elbasan | BESNIK SHISHMANI | 638,200 |
| Korçë | Neki Bylyku | EZAURUAR |
| Shkodër | Adil Zeka | 6,664,113 |
| Shkodër | Lec Cuni | - |
| Tiranë | ENVER SHEHU | 5,397,414 |
| Vlorë | Dhimiter Lako | |
| Vlorë | Afrim Agalliu | |
| Durrës | Lili Kylheku | |
| Elbasan | ENVER COTA | 1,990,596 |
| Elbasan | HYSNI HASA | |
| Elbasan | HAMIT SADIK MOJSJA | EZAURUAR |
| Kukës | Ibish Metalia | |
| Berat | Hekuran Abas Sulejmani | 4,065,760 |
| Tiranë | HYSNI BABAMETO | 35,202,255 |
| Tiranë | SHPRESA BALI | 935,803 |
| Tiranë | QEMAL ETJ MURATI | 6,094,179 |
| Tiranë | OSMAN VAQARI | |
| Berat | Tasi Vrusho | |
| Kukës | Ibish Metalia | |
| Fier | Gjolek Hamataj | 3,577,869 |
| Fier | Bushi Lako | |
| Fier | Tatjana Zotaj (Ruka) | |
| Fier | Mehdi Prodani | 6,168,252 |
| Gjirokastër | Vasil Tefa | |
| Korçë | Llazi Riza | |
| Korçë | Ferdinand Zhurka | |
| Korçë | Selami Sopoti | |
| Korçë | Maliq Osmanlliu | 160,000 |
| Korçë | Shaban Tefiku | 218,000 |
| Korçë | Ferzilet Jalli | 260,000 |
| Korçë | Sali Çoçka | 179,500 |
| Korçë | Haki Ahmet | 108,550 |
| Korçë | Dhora Thomi | 77,760 |
| Korçë | Çelnike Myrtollari | 441,800 |
| Korçë | Shaqir Ustalli | |
| Korçë | Gaqo Façe | |
| Korçë | | 550,000 |
| Korçë | Avni Zaçe | |
| Korçë | | 556,310 |
| Korçë | Ramadan Galla | |
| Kukës | Riza Muça | |
| Kukës | Azem Qaushi | 142,266 |
| Lezhë | Pjeter Trumshi | 750,000 |
| Tiranë | SINAN HETA | 20,827,359 |
| Korçë | Dhimitraq Samara | |
| Shkodër | Shefike Sokoli | |
| Vlorë | Elvira Miho | - |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | | |
| Korçë | Vangjo Ilo | 765,148 |
| Korçë | Faredin Shellira | 300,000 |
| Durrës | Gazmend Feri | 2,925,000 |
| Durrës | Hysni Ferri | |
| Durrës | Reshit Barometa | |
| Tiranë | SKENDER METANI (MATANI) | 21,049,002 |
| Tiranë | RAMAZAN GALIP STERMASI | 19,990,247 |
| Tiranë | HIQMET MYZYRI | 4,419,954 |
| Tiranë | VANGJO RACI | 22,769,460 |
| Tiranë | SALI RAMA | |
| Tiranë | NURIJE BRARI | 30,598,136 |
| Tiranë | NIKOLIN LACAJ | 47,481,021 |
| Tiranë | | EZAURUAR |
| Tiranë | RAMAZAN SINA | EZAURUAR |
| Tiranë | BEQIR QOKU | 26,318,817 |
| Tiranë | BEDRI PETRELA | 8,705,970 |
| Korçë | Vangjo Kokoneci | 1,020,000 |
| Durrës | Meliha Tasim Tufa | |
| Kukës | Arif Xhafa | |
| Lezhë | Ndue Lesh Ndoka | 220,447 |
| Tiranë | ARIFE PASHO | 143,628 |
| Tiranë | IDRIZ XHAJA | 375,690 |
| Tiranë | REXHEP XHAJA | 200,410 |
| Tiranë | SHYQYRI HAJDARI | EZAURUAR |
| Tiranë | SELIM TAKU | 1,158,400 |
| Tiranë | ARBEN KOROVESHI | |
| Tiranë | ARTAN MINAROLLI | 16,376,556 |
| Tiranë | THOMA LALA | 3,482,388 |
| Tiranë | MARGARITA SEMINI (TERCA) | 10,045,350 |
| Durrës | Raqi Manasterli | |
| Durrës | Dhora Koraqi | |
| Vlorë | Vangjel Papa | EZAURUAR |
| Dibër | Shahin Tomja | |
| Dibër | XHELADIN ALI BEKTESHI | |
| Dibër | SHPETIM GJOKA | |
| Berat | ZAIM CAUSHI | |
| Korçë | Bujar Hamolli, Zenepe Hamolli | 820,811 |
| Korçë | Nesim Basha | 421,098 |
| Korçë | Hymerli Spahollari, Kadimije Spahollari, Ze | 556,003 |
| Korçë | Mesli Zeka, Minire Zeka, Nexhmije Zeka | 315,096 |
| Shkodër | Fatmir Dilaveri | |
| Tiranë | SADIK SHERA | EZAURUAR |
| Durrës | Agim Leka | |
| Durrës | Haxhi Zaza | |
| Durrës | Mitrush Minia | |
| Tiranë | Hasan Beqir Alla | EZAURUAR |
| Korçë | Faik Adem | 155,627 |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Durrës | JORGJI MANUSHI | |
| Durrës | Maliq Bushati | |
| Durrës | Hajrie Shehu | |
| Fier | Veiz Siqeca | |
| Gjirokastër | Tefik Goraj | 701,720 |
| Korçë | Teki Kaçolli | |
| Korçë | Dajlan Jupa | |
| Korçë | Estref Kaçolli | 204,288 |
| Korçë | Baftjar Laho | 69,003 |
| Korçë | Haxhi Kasko, Naim Kasko | 275,328 |
| Korçë | Pandi Gjika | EZAURUAR |
| Korçë | Ilia Tili | |
| Korçë | Sali Mulla | |
| Shkodër | Cile Ceka | |
| Shkodër | Shefqet Sinani | 3,080,196 |
| Tiranë | MUHAMET SHKALLA | 6,763,869 |
| Tiranë | ADHURIM, AGIM MALE | |
| Tiranë | ADHURIM, AGIM MALE | 6,562,962 |
| Tiranë | IBRAHIM LALICA | 8,237,187 |
| Tiranë | ABDURAHMAN BEJTJA | 30,437,411 |
| Tiranë | SABAUDIN BOGDANI | EZAURUAR |
| Korçë | Lutfi Ibi | EZAURUAR |
| Tiranë | MYSLYM KURDARI | |
| Berat | Belul Çela | 973,343 |
| Gjirokastër | Zariqi Shehu | EZAURUAR |

| | | |
|---|---|---|
| Gjirokastër | Hyske Ngjelina | |
| Elbasan | PRANVERA,MYZEJEN,BURBUQE ABDIHOXHA | |
| Elbasan | HEKURAN VELAKU | 775,747 |
| Elbasan | VEZIRE BEGA | |
| Elbasan | RAMAZAN LLESHI | 1,161,181 |
| Elbasan | Nebi Zeneli | |
| Elbasan | KULTI BEKTASHJAN | |
| Elbasan | Xhevahir Kullolli | 431,784 |
| Elbasan | ZENEL LLAPUSHI | |
| Lezhë | Nikolle Mark Deda | |
| Lezhë | Pjeter Ded Lleshi | 3,290,250 |
| Shkodër | Dede Gjon Markagjoni | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | ADEM KORRA | 3,214,512 |
| Tiranë | REXHEP FAJA | 6,629,931 |
| Tiranë | REXHEP FAJA | 21,430,080 |
| Tiranë | REXHEP FAJA | 34,689,942 |
| Tiranë | QANI KARAKASHI | |
| Tiranë | RESHAT FAJA | 8,572,032 |
| Tiranë | | 16,139,529 |
| Tiranë | IBRAHIM LALA | 4,330,895 |
| Tiranë | XHAVIT DRINI | 40,171,815 |
| Tiranë | AZIZ XHELADIN XHABAFTI | 28,320,360 |
| Tiranë | MEHMET DAUTI | 11,250,792 |
| Tiranë | BUJAR MARA | 2,410,884 |
| Tiranë | BUJAR MARA | 14,030,006 |
| Tiranë | MAHMUDIE MUHAXHIRI | 8,069,765 |
| Tiranë | AGIM FERHATI | - |
| Tiranë | PAVEL KOJA | |
| Gjirokastër | Stefanaq Juanidhi | |
| Gjirokastër | Telat Ahmeti | 158,565 |
| Gjirokastër | Muharem Dino | 287,245 |
| Gjirokastër | Petraq Popli | |
| Gjirokastër | Llambrini Cela | 156,125 |
| Korçë | Zeme Gora | |
| Shkodër | Trash Hoxhaj | - |
| Shkodër | Zef Pjeter Fusha | 2,794,500 |
| Shkodër | Tom Lumci | 270,900 |
| Korçë | Nevrus Lilka | |
| Fier | Nasi Bare | |
| Fier | Asqeri Balla | |
| Fier | Demir Ferko | 8,131,520 |
| Fier | Hysen Spahiu | 2,514,662 |
| Lezhë | Dava Ndue Legisi (Nikolli) | |
| Shkodër | Nestret Maliq Dermani | |
| Shkodër | Hamdi Bazhdari | 330,021 |
| Shkodër | Irfan Gjyrezi | |
| Tiranë | Hajrije Gjata (Demrozi), Nafije Demrozi, Qe | 437,570 |
| Tiranë | Emine Lecini, Emri Lecini, Feride Lecini, Fiqirete Lecini, Izet Lec | |
| Tiranë | Ramazan Vrapi | 1,974,000 |
| Tiranë | Anife Xherri, Anife Xherri, Bajram Xherri, B | 3,350,536 |
| Tiranë | ISUF, HAXHI KOKOSHI | |
| Tiranë | MUHAMED XHELEZI | - |
| Tiranë | | |
| Tiranë | FATIME,YMER ARKAXHIU | 3,872,500 |
| Tiranë | SEID TAFAJ | EZAURUAR |
| Tiranë | ZENEPE CASLLI | EZAURUAR |
| Tiranë | XHEMAL VORPSI | 24,443,685 |
| Tiranë | MUSA DEMNERI | |
| Durrës | Kujtim Kasmi | |
| Durrës | Rexhep Molla | EZAURUAR |
| Vlorë | Shkëlqim Musaj | 592,735 |
| Vlorë | trashëgimtarët | |
| Durrës | Muhamet Sefa | |
| Vlorë | Dhionis Çili | 2,823,877 |
| Vlorë | Kujtim Kreshpa | |
| Lezhë | Ndue Gjok Kaçorri | |
| Durrës | Denis Zazani | |
| Durrës | Hysen Tepelena | |
| Durrës | Haki Kokomani | |
| Vlorë | Hamza Xhyheri | |
| Kukës | Elez Metalija | |
| Elbasan | SHEFQET MANA | |
| Fier | Mehdi Molosiu | 4,983,200 |

*(Vijon nesër)*

Opinioni i Ditës

# Fytyra e vërtetë e "demokracisë" kapitaliste

Nga Fitim Çaushi

*(vijon nga faqja 1)*



... juridike, sepse kjo marrëveshje nuk do të ratifikohej në parlament. Kundërshtarët e saj bazoheshin te fakti se kontrolli efektiv i institucioneve kosovare mbi ato territore ka ekzistuar pandërprerë gjatë gjithë periudhave kohore, që nga vënia e kufirit administrativ (1945-46) në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Këtë e argumentoi saktë edhe komisioni i dytë: vija kufitare në marrëveshjen për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nuk ishte në përputhje me vijën administrative kufitare të ish–Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Prandaj, marrëveshja u prit në Kosovë me kundërshtime të mëdha. Me ratifikimin e sforcuar dhe të tensionuar nga shumica e parlamentit të Kosovës, marrëveshja që i jep Malit të Zi 8.000 km katrorë nga tërësia territoriale e Kosovës dhe trungu kombëtar, sipas Konventës së Havanës për Traktatet (1928, fiton në aspektin ndërkombëtar detyrim kushtetues.

Shikuar nga këndi i së drejtës ndërkombëtare, duket se shtetet e treta nuk duhet të kishin asnjë arsyetim ndërkombëtar juridik për të kërkuar nga shteti i Kosovës ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërkohë që ato përmes ndërhyrjeve diplomatike i kishin vënë Kosovës kushte të hekurta dhe deputetët e Kosovës, për t'i hapur rrugë liberalizimit të vizave në Evropë, pranuan me dhimbje të japin pjesë nga territori i tyre!

SHBA dhe Greqia shpejtuan të parat ta përshëndesin këtë masakër të trojeve shqiptare, ndonëse ambasadori Lu, në vigjilje të këtij ratifikimi, lexoi edhe vargje nga poetë shqiptarë, por çuditërisht paska harruar Kadarenë, i cili i drejtohet Shqipërisë:

"Shekujt si qentë të kafshuan ku mundën të të hanë/ mes tyre tek shkoje ata të suleshin/ dhe dhëmbët e kohrave në ije të nguleshin".

Sigurisht, Greqia mbeti tepër e kënaqur nga kjo masakër e territoreve shqiptare, sepse shpreson të mbetet e kënaqur edhe nga marrëveshja që do të nënshkruhet me detin shqiptar! Por, si ta kuptojmë kënaqësinë e madhe të SHBA-ve, kur e di mirë se Shqipërisë i rrëmbyen me vendim të Kongresit të Berlinit më 1878, copa të shenjta shqiptare për Malin e Zi, si: Ulqini, Tivari, Gruda, Hoti, etj.? I rrëmbyen me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në 1913 në Londër: Çamërinë dhe troje të Juglindjes për Greqinë si Kosturi, Konica, Follorina etj.? I rrëmbyen Tetovën, Gostivarin, Shkupin, Kërçovën, Manastirin, Ohrin, Strugën etj. për Maqedoninë? I rrëmbyen Preshevën, Bujanovcin dhe Metvegjën në 1945, për Serbinë dhe pikërisht tani në 2018, në botën demokratiko-kapitaliste, i rrëmbyen edhe 8000 km katrorë për të kënaqur Knjazët e rinj malezezë, duke i kërkuar edhe Mitrovicën peshqesh për Serbinë! Vetëm Shqipërisë së gjorë, e cila ka sakrifikuar nëpër histori për Evropën, do t'i rrëmbejnë copa nga trupi i saj?! Mjafton të kujtojmë se në kohën e Skënderbeut populli shqiptar u bë ledhi mbrojtës i krishtërimit evropian. Në pushtimin osman, shqiptarët u sakrifikuan për çlirimin e Greqisë, e po ashtu edhe në kohën e Garibaldit për lirinë e Italisë.

Është e qartë se kushtet poshtëruese dhe zhvatëse, të vëna nga faktori ndërkombëtarë për të hyrë në Europë, janë vetëm për Shqipërinë. Asaj i kërkohet që të "rregullojë" problemet me fqinjët pastaj të nisnin negociatat! Përse s'u kërkojnë fqinjëve të tërhiqen nga pretendimet e tyre territoriale? Ç'punë do t'i prishte Evropës futja e Shqipërisë në bashkësinë e saj, pavarësisht problemeve me fqinjët? A nuk kanë probleme territoresh edhe vendet anëtare të BE mes njëri-tjetrit?

Rruga e integrimit evropian nuk i ka zbutur ndjenjat dhe vizionet e vjetra ballkanuke mbi sovranitetin apo kufijtë dhe marrëdhëniet me fqinjët. Ende mentaliteti ballkanik mbizotëron mbi mentalitetin evropian dhe ambiciet për kufij shtohen edhe më shumë, ndonëse shtetet e shohin njëri-tjetrin së bashku në karrigen evropiane. Nëse në Evropën e Bashkuar kufijtë do të kenë kuptim simbolik, përse Mali i zi, si pjesë e NATO-s, që kërkon të aderojë në BE, i kërkon Kosovës pjesë të territorit të saj?!

Konfliktet për territore detare dhe tokësore kanë pasur edhe dy shtetet ballkanike: Sllovenia si anëtare e BE qysh në 2004 dhe Kroacia që ka marrë statusin e vendit kandidat qysh më 2005-ën. Mes tyre ekziston një acarim që merr përmasat e një konflikti të acaruar, derisa Sllovenia vendosi veton e saj për hapjen e kapitujve të rinj të Traktatit të pranimit të Kroacisë në BE. Me gjithë këtë konflikt, Kroacia u pranua si anëtare e BE në 2011.

Për kufirin detar janë përplasur edhe vende të tjera të BE: Rumani-Bullgari. Kufiri detar midis tyre është caktuar qysh në vitin 1940, por në datën 9 dhjetor 2013 u zhvilluan në Sofje bisedimet të mes sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Jashtme të Bullgarisë dhe sekretarit të shtetit të Rumanisë për delimitimin e kufijve detarë. Që nga viti 1994 kanë vazhduar bisedimet mes tyre në nivelin e ekspertëve për njëzet vjet. Diskutimi i kufirit detar midis Rumanisë dhe Bullgarisë ngrihej në një kohë kur ishin nënshkruar dokumentet e në procesin e anëtarësimit të tyre në BE dhe ishte sanksionuar realiteti faktik se midis tyre nuk ekzistonin grindje dhe konflikte territoriale. Këto grindje, për arsye të pasurive nëntokësore, e kanë bërë shumë të mprehtë dhe të ashpër konfliktin mes tyre, por kjo nuk i pengon që të jenë anëtarë të BE pa kushtëzime. Përse kushtëzohet Kosova dhe Shqipëria?!

Janë rizgjuar tensionet e fjetura për territore midis Bullgarisë dhe Serbisë, ndonëse Serbia ka shprehur gatishmërinë për statusin e shtetit kandidat të BE–së. Pa përmendur konfliktet e ndezura midis Greqisë, si vend anëtar i BE dhe Turqisë së vend anëtar i NATO-s.

Ndjehet se për të justifikuar këtë masakër shqiptare në rregullimin e balancës gjeopolitike të Evropës dhe SHBA-ve, u evidentua fantazma ruse, aq shumë e përforcuar kohët fundit, kur dihet se vende të BE-së nuk kanë pasur asnjë pasojë dhe asnjë kusht për politikën e tyre të jashtme edhe me Rusinë!

Qeveria greke plotësoi kërkesën e Rusisë për kalimin nëpër hapësirën ajrore greke të aeroplanëve ruse që fluturojnë me ndihma në drejtim të Sirisë, ndonëse më 9 shtator 2015, qeveria e SHBA i kishte bërë kërkesë zyrtare Greqisë, që të mos hapte korridoret e saj ajrore për kalimin e aeroplanëve ruse të ndihmave në Siri. Ndonëse qëndrimi i Greqisë është konsideruar si një hap diplomatik dhe strategjik i dyshimtë, që shton në Perëndim dozën e mosbesimit për vokacionin e saj atlantik, ajo nuk ka pësuar asnjë sanksion, përkundrazi po ndihmohet diplomatikisht që të rrëmbejë edhe pjesë nga deti shqiptar!

Sllovenia është i vetmi shtet i BE, e cila pas vendosjes së sanksioneve të BE ndaj Rusisë, zyrtarisht u është bashkuar saksioneve ndaj Rusisë, por ajo është ndër vendet që ka kërkuar zbutjen dhe heqjen e sanksioneve, si kombe që kanë lidhje historike me Rusinë, duke u mbështetur në identitetin etnik sllav të përbashkët, ndonëse ka përqafuar identitetin evropian dhe atlantik!

Bullgaria është pjesë e BE qysh në vitin 2007, por pjesë të territorit të saj ajo i ka shitur tek biznesmenë rusë. Blerjet masive nga pronarë rusë në bullgari në vitet 2006-2014 janë 63574 prona rezidenciale. Nga kufiri me Rumaninë e deri në kufirin me Turqinë, rusët zotërojnë 80% të pronave të patundshme: hotele, restorante, pallate dhe shtëpi private. Ndonëse kryeministri i Bullgarisë në 2014, iu zotua presidentit të Komisionit Europian se ndërtimi i gazsjellësit në territorin bullgar do të bëhet sipas ligjeve të BE-së, pikërisht në këtë kohë u publikua se qeveria bullgare i kishte dhënë tenderin e ndërtimit të gazsjellësit "South Stream" në territorin bullgar një kompanie ruse, e cila ndodhet në listën e zezë të sanksioneve të SHBA ndaj Rusisë!

Mali i Zi është anëtar i NATO-s dhe po privilegjohet në kurriz të trojeve shqiptare, ndonëse mediat malazeze propagandojnë se rusët zotërojnë 40% të pasurive të patundshme, sidomos në bregdet. Po kështu, Spanja i bashkohet bojkotit të Serbisë dhe ngrihet kundër BE!

Sikundër shihet, politikat e BE dhe SHBA për të rregulluar gjeopolitikën e tyre janë në dëm të interesave territoriale të Shqipërisë dhe Kosovës. Ky qëndrim ka qenë konstant nëpër histori: Deklarata që ministri i Jashtëm britanik Eduard Grei, që drejtonte Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, një ditë pas mbarimit të konferencës, më 12 gusht, bëri në Dhomën e Komuneve lidhur me caktimin e kufijve të Shqipërisë, është po aq aktual sa edhe sot. Ai tha shprehimisht: "Unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale. Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhet marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha dhe në qoftë se vendimi mbi Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Europë" (E. Grey, "Speeches of foreing affairs", London 1913, p. 212)

Ndryshimi qëndron se atëherë vendimet i merrte faktori ndërkombëtar, tani vendimet për copëtimin e truallit kombëtar i marrin vetë shqiptarët të imponuar me diktat nga të mëdhenjtë.

Historia na ka mësuar se në vitin 1915 ishte Lenini që e shpëtoi Shqipërinë nga copëtimi përfundimtar përmes Traktatit të fshehtë të Londrës. Pikërisht për këtë akt proshqiptar, Avni Ristemi e ngriti në këmbë Parlamentin Shqiptar më 22 prill 1924, për të mbajtur pesë minuta heshtje për vdekjen e Leninit.

Njëzet e tre vjet më vonë ishte Stalini, që e shpëtoi Shqipërinë nga kthetrat e Titos dhe serbëve, përmes letrës së Informbyrosë në vitin 1947. Këtë të vërtetë historike populli shqiptar dhe historia e ka shkruar me shkronja të arta. Si shpjegohet që fuqitë evropiane vazhdojnë të pranojnë që Shqipëria të copëtohet?! Kjo na tregon se Shqipëria ndodhet nën një diktat të egër "demokratik". A duhet të pranojnë shqiptarët pazare me trojet e tyre, vetëm se na ndihmuan të çlirohej Kosova?!

Opinioni i Ditës

# Çfarë tha realisht FMN?

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*

... shumë qartë dy ditë më parë. Tha se si vend dhe ekonomi kemi boll rreziqe përpara. Sidomos me kostot e kontratave të Partneriteteve Publik-Privat, që mendohet të nënshkruhen gjatë këtij viti, në nivel deri 1 miliard euro (pesë boshte rrugore dhe spitali shtetëror i Fierit). Ndërsa kryetari i opozitës kryesore të vendit theksoi nivelin rekord të borxhit tonë publik. Në fakt, ai është ndalur në rritjen e tij në këto dy vitet e fundit, në sajë të disiplinimit të financave publike dhe ky duhet konsideruar sukses. Po devijues u tregua dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë në kundërthënien e tij ndaj drejtuesit të opozitës, në një përgjigje në rrjetet sociale. Ministri përmendi sfidat e pamohueshme që kishte renditur FMN. Në fakt, kjo strukturë ndërkombëtare vrojtimi dhe këshillimi nuk foli thjesht për sfida të pamohueshme.

Në deklaratën përmbyllëse të misionit të vet në Tiranë, FMN i mëshoi fort nevojës për pakësimin e vendimmarrjeve të fragmentuara për partneritetet (bashkëpunimin) publik-privat, të mbiquajtura PPP. Tha se praktika e tanishme e propozimeve të pakërkuara (vetë biznesi i ofrohet qeverisë për një ndërtim apo shërbim publik, pa dalë kjo e fundit në tender, në ankand) duhet të eliminohet. Këto kërkesa janë më shumë se renditje sfidash të pamohueshme. Janë shqetësime serioze, që rrezikojnë të kthejnë qasjen e Partneriteteve Publik-Privat në një aventurë të rrezikshme për Buxhetin e Shtetit, me humbje nga dhjetëra në qindra milionë euro, e ngjashme me kuturisjen me rrugën e kombit 10 vite më parë, e cila doli tri herë më e shtrenjtë se parashikimi.

Të paktën aty ishin para thjesht të Buxhetit të Shtetit dhe jo detyrime të shtrira në kohë ndaj privatit. Këto kontrata të sotme ose të një të ardhmeje të afërt për PPP-të mund të jenë me pasoja afatgjata negative për ne dhe brezat që do të na pasojnë. “Këshilla” e përmendur nga përfaqësuesi i FMN në Shqipëri për qeverinë, vetëm pak ditë më parë në një intervistë televizive, që të marrë një pushim të shkurtër dhe të pezullojë përkohësisht dhënien me vërtik të koncesioneve dhe Partneriteteve Publik-Privat është po ashtu kërkesë shumë e fortë. Paraqet një kambanë alarmi. Nëse këto do t’i thoshte kryetari i opozitës, qeveria do të vendosej përpara një përgjegjësie të dyfishtë. Përpara forcës politike që do t’i kërkojë pushtetin dy vite e gjysmë më vonë dhe llogari nëse 3 P-të ecin keq, si dhe përpara një institucioni ndërkombëtar me emër (FMN), të cilit, edhe pse tani nuk i ka më nevojën për para sikurse ia kishte katër vjet më parë, sërish interesohet të mos i dalë përballë në kundërshti. Mungon përgjegjësia përpara qytetarit, ajo kryesorja, pasi për fat të keq, për rreziqet e



Partneriteteve Publik-Privat qeveria nuk është se ka organizuar ndonjë dëgjesë publike.

Nga ana tjetër, shoqërinë civile e kemi ende të përgjumur për kësi nismash, ngaqë ose nuk di shumë nga ekonomia, ose nuk ka para donatorësh të huaj në treg për to. Misioni i FMN-së e tha shqeto se “nevojitet... fuqizimi i proceseve të vlerësimit të rrezikut brenda Ministrisë së Financave, ...po të kemi parasysh detyrimet e mëdha të kushtëzuara, që shpesh janë pjesë e kontratave të PPP-ve”. Pra, FMN shpreson që Ministria e Financave të bëjë oponencën e duhur teknike për rreziqet nga koncesionet dhe PPP-të. Mirëpo ne e dimë fort mirë se të gjitha dikasteret tona janë të politizuara deri në rrënjë të flokëve. Si zor të dalë prej tyre përballje e bazuar në interesat thjesht ekonomikë të qytetarëve dhe të vendit. Si gjithmonë, do të mbizotërojnë interesat afatshkurtra partiake të forcës politike në pushtet. Prandaj dhe duhet një nismë nga Kuvendi që të ndryshohet ligji për koncesionet dhe PPP-të, për ta nxjerrë oponencën profesionale jashtë duarve të qeverisë, si njësi vlerësuese e pavarur. Për t’ia lënë Kuvendit ta mbikëqyrë, t’i caktojë buxhetin dhe njerëzit.

Mund të niset edhe me 2-3 koordinatorë, të cilët të kontraktojnë ekspertë të fushës me para të Kuvendit, por kurrsesi jo të qeverisë! E pamë seç ndodhi me kompaninë shfrytëzuese të koncesionit të naftës, Bankers, e cila kontraktoi me paratë e saj një kompani ndërkombëtare vlerësimi (auditimi) për financat e saj në Shqipëri, për të cilat Agjencia jonë Kombëtare e Burimeve Natyrore pretendonte me të drejtë se në vitin 2011 kishin rritur artificialisht shpenzimet prodhuese për të mos paguar tatimin mbi fitimin. Gabimi fatal ishte që audituesi ndërkombëtar bëri vlerësimin e tij vetëm me paratë e “Bankers”. Kjo na solli një humbje prej 57 milionë dollarësh në Buxhetin e Shtetit. Ka ardhur koha të mos bëjmë më kësi lloj gabimesh. Ka ardhur koha të funksionojë realisht oponenca e pavarur dhe profesionale që kërkon edhe FMN. Nëse nismën nuk e merr Kuvendi, duhet që ne si qytetarë të provojmë me anë të rrjeteve sociale për të organizuar punën të mblidhen 20 mijë firma për të çuar këtë sprovë ligjore në Kuvend, krijimin e një strukture oponence profesionale të pavarur nga qeveria për koncesionet dhe PPP-të. Ndryshe do ta paguajë si gjithmonë, e ardhmja e fëmijëve tanë.

> Në deklaratën përmbyllëse të misionit të vet në Tiranë, FMN i mëshoi fort nevojës për pakësimin e vendimmarrjeve të fragmentuara për partneritetet (bashkëpunimin) publik-privat, të mbiquajtura PPP. Tha se praktika e tanishme e propozimeve të pakërkuara (vetë biznesi i ofrohet qeverisë për një ndërtim apo shërbim publik, pa dalë kjo e fundit në tender, në ankand) duhet të eliminohet. Këto kërkesa janë më shumë se renditje sfidash të pamohueshme. Janë shqetësime serioze, që rrezikojnë të kthejnë qasjen e Partneriteteve Publik-Privat në një aventurë të rrezikshme për Buxhetin e Shtetit

## HOROSKOPI

### DASHI
Këshillohet të përballoni çështje të pazgjidhura në fushën e dashurisë. Duhet t’i shqyrtoni gjërat nga çdo këndvështrim, pa u fshehur pas iluzioneve. Nëse një epror ju kërkon të punoni përtej kompetencave tuaja, qëndroni të qetë dhe refuzoni.

### DEMI
Një e fshehtë sot, një fshehtë nesër, rrezikoni të mos mbani më mend se cila është kështjella e fantazisë që keni ndërtuar. Më mirë të ktheheni në realitet! Nëse keni në mendje një lidhje nga e kaluara, mos u angazhoni për të ardhmen.

### BINJAKET
Duhet të punoni për të harmonizuar kërkesat e ndryshme që rrezikojnë të bien ndesh me njëra-tjetrën. Mësoni të dëgjoni më shumë të tjerët. Nëse nuk arrini të gjeni një marrëveshje të kënaqshme, mos u nxitoni, më mirë të ndryshoni vendimin.

### GAFORJA
Humori do t’ju ndryshojë dhe nuk do t’ia dilni të shfrytëzoni mundësitë që do të keni gjatë ditës. Mirëkuptimi me partnerin do të jetë i pakët. Përqendrohuni në përmbushjen e objektivave afatshkurtra, edhe pse bëni zgjedhje largpamëse.

### LUANI
Duke vëzhguar, do të zbuloni se jeta në çdo ditë mund t’ju dhurojë ato gjërat e vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, jeni shumë të ndjeshëm dhe përfshiheni shpejt në gjendjen emocionale të të tjerëve.

### VIRGJERESHA
Ditën e sotme do të kuptoni se nga kanë ardhur disa tensione ekzistuese në shtëpi si edhe do t’ju jepet mundësia t’i zgjidhni. Do të gjeni zgjidhje të papritura për probleme që ju kanë bërë të ndiheni të bllokuar, duke bërë të merrni frymë lirisht.

### PESHORJA
Bën mirë të merrni parasysh veprimet tuaja, sepse ndodh që persona që ju rrethojnë mund të shqetësohen për ju. Vazhdoni të angazhoheni për punët profesionale, por lejojini vetes edhe pak kohë të lirë dhe shijoni emocione të ndryshme nga e zakonshmja.

### AKREPI
Bëni kujdes nga marrëveshjet e bëra dhe padituria e juaj në situata pak të qarta. Por mos reagoni në mënyrë të tepruar. Me Saturnin që e keni kundra, sot do të ndiheni se jeni pushtuar nga mëdyshje që do të bëjnë të jini të paqartë. Por gjërat do të rregullohen.

### SHIGJETARI
Bashkëveprimi i planetëve ju sjell fatin në anën tuaj dhe mbi të gjitha, do të bëjë që punët të mos ju marrin shumë kohë nga kënaqësia. Në punë parashikohen bashkëpunime të reja, projekte të reja dhe perspektiva të reja më fitimprurëse.

### BRICJAPI
Pritet që ditën e sotme të keni keqkuptime të mundshme në familje e për rrjedhojë një ndjenjë fajësie për çdo gjë pa arsye. Klima e ftohtë ju bën të mbylleni në shtëpi, por angazhime të ndryshme ju shtrëngojnë të jeni në lëvizje. Me durim do t’ia dilni.

### UJORI
Thellohuni në gjërat që ju përshtaten e ju interesojnë më shumë dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Jupiteri ju mbështet dhe do të bashkëpunojë për t’ju ndihmuar të zgjeroni horizontin dhe të pasuroni lidhjet me të tjerët.

### PESHQIT
Sot nuk është dita për të marrë vendime të nxituara. Para se të veproni, mendohuni mirë! Druajtja se mos dilni keq, për fat do t’ju shpëtojë. Ndikimi i Saturnit do të bëjë që të jeni jo të qetë, jo të saktë dhe të shpërqendruar. Mundohuni të mos ndikoheni!

KORÇARËT DHE PARTIZANI JANË NË PRITJE




## Titulli i revokuar Skënderbeut, KAS vendos më 13 prill

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ka caktuar datën 13 prill si ditën kur do të marrë vendimin për fatin titullit kampion të ekipit të Skënderbeut për sezonin 2015-2016, informon "Supersport". Çështja është mes klubit dhe FSHF-së, me Komisionin e Etikës pranë institucionit të futbollit që vendosi t'ia heqë titullin pas pezullimit të parë që UEFA-s. Drejtuesit e skuadrës të Skënderbeut vendosën që ta apelonin vendimin në dyert e organit më të lartë të drejtësisë sportive, pasi e cilësonin atë si të padrejtë. Tashmë mbetet për t'u parë se çfarë vendimi do të marrë KAS, pra se cilës palë do t'i japë të drejtë, FSHF-së apo klubit bardhekuq. Nëse gjyqi fitohet nga qeveria e futbollit në vend, atëherë do t'u duhet të shqyrtojnë mundësinë për t'ia dhënë titullin ekipit që është renditur i dyti, Partizanit. 15-herë kampionët e vendit kanë shprehur hapur pretendimet se u takon atyre trofeu i sezonit 2015-2016.

Italiani e grumbulloi atëherë kur Naser Aliji ishte pa ekip, tani ai kërkon ta shpërblejë

# Aliji: Falënderoj Panuçin, dua të shfrytëzoj mundësinë

*Mbrojtësi do shfrytëzojë mungesën e Agollit*



Jeton Selimi

Emërimi i Kristian Panuçit si trajner i Kombëtares Shqiptare ishte si një bekim për Naser Alijin. Mbrojtësi nga Kumanova ishte lënë në harresë jo vetëm nga përfaqësuesja, por e kishte të pa mundur të gjente dhe një skuadër. Panuçi besoi shumë tek Aliji duke e grumbulluar në Kombëtarë pikërisht ne momentin e tij më të vështirë ndërsa më pas loboi duke e transferuar në Serinë B te Virtus Entella. Gjërat kanë ndryshuar shumë që nga ajo kohë pasi tashmë, Aliji ka gjetur vazhdimësi në klub, por është duke u projektuar dhe si pasues i kapitenit Ansi Agolli. Aliji në konferencë për shtyp falënderon Panuçin për mbështetjen dhe shpreson shumë që të zbres si titullarë në miqësoren kundër Norvegjisë.

**Ansi Agolli nuk është grumbulluar, mendoni se ka ardhur momenti yt?**

Një shans shumë i madh për mua, sepse Ansi nuk është grumbulluar. Shpresoj që të jem pjesë e formacionit jo vetëm për këtë ndeshje, por edhe në vazhdimësi.

**Sa të ka ndihmuar Panuçi në karrierën tënde?**

Më ka ndihmuar shumë dhe dua ta falënderoj. Nuk është normale që të grumbullojë një lojtar pa ekip. Ka qenë një mundësi e mirë për të treguar veten dhe për të gjetur ekipin e ri.




**Çfarë të ka thënë personalisht Panuçi?**

Më ka kërkuar të jem i gatshëm dhe të bëj stërvitje çdo ditë për të qenë mirë fizikisht. Nuk doja të rrija pa ekip, tani jam në Serinë B me Virtus Entelan dhe duhet të tregoj veten.

**A je gati për vendin e titullarit?**

Unë jam në formë shumë të mirë dhe në fund vendos trajneri për formacionin. Nuk dua të zëvendësoj Ansin, sepse jemi pak ndryshe. Unë dua të jem Aliji. Ansi ka vite në skuadër dhe është një person shumë pozitiv.

**Sa ndryshon Panuçi nga De Biazi?**

Trajnerët italiane kanë pak a shumë të njëjtin taktikë. Kanë ndryshuar gjëra të vogla, por jo shumë.

ISH-LOJTARI I PARTIZANIT

## Ramadani shpreson në një fanellë titullari

Një tjetër element cilësorë tek i cili Panuçi beson shumë është edhe Ylber Ramadani. Ish-mesfushori i Partizanit nuk i trembet konkurrencës, por pret momentin e tij. "Çdo lojtar që është në Kombëtare, ka dëshirë të luajë nga minuta e parë. Është detyra e trajnerit pastaj të vendosë. Jemi një grup shumë i mirë, i harmonizuar. Dua ta falënderoj trajnerin për besimin që ka treguar ndaj meje dhe dua t'ia shpërblej. Nëse futem në fushë, do të bëj maksimumin për çdo minutë. E kam pritur që kur kam qenë fëmijë ftesën, e kam ëndërruar Kombëtaren gjithmonë. Mendoj se është shumë mirë kur ka konkurrencë të madhe në ekip dhe dua të bëj maksimumin. Nuk është vendosur se kush luan, por besoj se do të luaj nga minuta e parë. Trajneri Sormani më ka ndihmuar shumë, e kam edhe në Danimarkë. Ai ka punuar shumë me mua dhe është i ngjashëm me trajnerin Panuçi në mënyrën e punës. Te U-21 ka përgjegjësi të tjera. Ne kishim përgjegjësi të shkonim në vendet e para dhe bëmë ndeshje të mira, por na ka munguar fati. Por me Kombëtaren A ka edhe më shumë përgjegjësi. Gjithë ekipi është mirë fizikisht dhe do të hyjmë në fushë për ta fituar ndeshjen, për të rritur moralin e ekipit.



NË STËRVITJE PROVOI SKEMËN 4-3-3

## Panuçi kërkon modul të ri ndaj Norvegjisë

Shqipëria e Kristian Panuçit po merr formë. Kuqezinjtë vijojnë përgatitjet me intensitet të plotë, dy seanca stërvitore në ditë për të qenë gati për miqësoren kundër Norvegjisë. Takimi i fundit i Shqipërisë, ai kundër Turqisë, ishte një sfidë që si rrallë herë kuqezinjtë e interpretuan në sulm, një ndeshje, e cila tregoi qartë se qëllimi i teknikut italian është të krijojë një Kombëtare më sulmuese, dukë thyer në këtë mënyrë një tabu gati shekullore. Afrimet që Panuçi ka bërë në Kombëtare, janë, gjithashtu, një tregues i qartë, pasi pjesa më e madhe janë lojtarë fantazist, ose me mesfushorë me tipare të theksuara sulmuese, si rastet e fundit të Gazavajt dhe Abazajt. Edhe gjatë seancës së fundit stërvitore u pa qartë se Panuçi kërkon të ndryshojë modul, nga ai tipik 3-5-1 provoi skemën 4-3-3. Një skemë, e cila funksionoi në perfeksion dhe pritet që ndaj Norvegjisë, Shqipëria të luajë më këtë modul, i cili pritet të jetë dhe e ardhmja e Kombëtares. Fill pas miqësores kundër Turqisë, Panuçi u shpreh se Shqipëria duhet të guxojë më shumë. Ky grumbullim po shkon në mënyrën më të mirë të mundshme pasi me grupin janë bashkuar edhe Berisha, Hysaj dhe Gjimshiti.



SKANDAL NË ARGJENTINË

## Prostitucion me minorenët te ekipet e moshave të Independientes

Një çështje abuzimi dhe shfrytëzimi të minorenëve shpërthen në futbollin argjentinas, pikërisht një nga klubet më prestigjioze të këtij vendi, Independiente Avellaneda. Bëhet fjalë për një skandal që është zbuluar pas rrëfimit të bërë dje nga gazetari Gustavo Grabia në programin "No Todo Pasa". Abuzimi ka ndodhur tek ekipet e moshave të Independientes dhe bëhet fjalë për një seri shfrytëzimi seksual të organizuar nga një ish-futbollist dhe një gjyqtar. Çështja shpërtheu pas deklarimit të një futbollisti të ri në moshë. Ai ia ka rrëfyer abuzimin e pësuar, psikologut të konviktit ku qëndrojnë lojtarët e moshave të Independientes. Djaloshi 17-vjeçar deklaroi se ata ishin shfrytëzuar për qëllime prostitucioni në një apartament luksi në Buenos Aires, ku ai së bashku me tre shokët e tij moshatarë ofronin shërbim seksual në këmbim të parave. Ai që e drejtonte rrjetin e prostitucionit të minorenëve ishte një ish-futbollist i Independientes së bashku me një gjyqtar që drejton ndeshje të kampionatit të moshave në Argjentinë. Stafi mjekësor i Independientes ia ka rrëfyer historinë, Fernando Beronit, koordinatorit të të gjitha kategorive inferiore të klubit argjentinas.




www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
Sherri për kafshët, Roza Lati: Do t'i jap kastravecë
BLUE TOOTH
500 NUMRA, NJE HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!